FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Viti: 2025 – Numri: 202

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E premte, 31 tetor 2025

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 616, datë 29.10.2025	Për përcaktimin e elementeve të cilësisë për klasifikimin e statusit ekologjik të lumenjve, liqeneve, ujërave tranzitore, ujërave bregdetare dhe trupave ujorë sipërfaqësorë artificialë dhe tepër të modifikuar, klasifikimin e statusit ekologjik të tyre, si dhe kërkesave për kryerjen e analizës së karakteristikave dhe vlerësimin e ndikimit të aktivitetit njerëzor në statusin e ujërave sipërfaqësore për çdo basen lumor ose liqenor.....	24343
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 617, datë 29.10.2025	Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për Arkivin Qendror Teknik të Ndërtimit, të një pjese të pasurive me nr. 4/697 dhe nr. 4/589, zona kadastrale 8260, Tiranë, dhe për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Arsimit, për Universitetin Politeknik të Tiranës, të një pjese të pasurive me nr. 4/697, nr. 4/654, nr. 4/589 dhe nr. 4/696, zona kadastrale 8260, Tiranë.....	24366
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 618, datë 29.10.2025	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikonstruksioni i bllokut të kufizuar nga rrugët 'Ali Baushi', 'Arben Minga', 'Kongresi i Manastirit', 'Ibrahim Brahja' dhe 'Xhanfize Keko'", Bashkia Tiranë.....	24372
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 619, datë 29.10.2025	Për kalimin te Bashkia Tiranë të njësive të banimit në ndërtesa (pallat)	24375
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 620, datë 29.10.2025	Për kalimin në pronësi të shtetit dhe në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Financave të dy objekteve publike për përdorim nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.....	24375

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 624, datë 29.10.2025	Për shpalljen e një zone me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore në Bashkinë Përmet.....	24376
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 625, datë 29.10.2025	Për shpalljen e disa zonave me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore në Bashkinë Elbasan.....	24378
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 626, datë 29.10.2025	Për shpalljen e një zone me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore në Bashkinë Skrapar.....	24383
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 627, datë 29.10.2025	Për shpalljen e disa zonave me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore në Bashkinë Belsh.....	24384
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 9.10.2025	Çështja Tom Ndreca kundër Shqipërisë (*kërkesa nr. 34288/19*).....	24387
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 43, datë 24.7.2025	Me objekt shfuqizimin pjesërisht të vendimit nr. 425, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar", pikërisht pika 2.ii, vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit për grupin vetëm nivelet 6 dhe 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve *(KSHK),* master profesional, dhe niveli 6 dhe të lidhjes nr. 4, si pjesë përbërëse e vendimit për pjesën e vlerës së shtesës së nivelit të kualifikimit për grupin e diplomës 2, KSHK 7 dhe grupi i diplomës 3, KSHK 6, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.	24390
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 271, datë 31.10.2025	Mbi shqyrtimin e kërkesave të Shoqatës "Taksitë e Klasit të Parë" dhe Sindikatës Shqiptare të Taksive për pezullimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 255, datë 15.10.2025 "Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për karikimin e makinave elektrike në pikat/stacionet e karikimit, me fuqi të instaluar mbi 11 kW".....	24399
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 356/15, datë 28.10.2025	Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 1056, datë 14.12.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësim për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor '*By Pass – Fier'*", të ndryshuar.....	24402
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 425/10, datë 29.10.2025	Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 684, datë 23.10.2019, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Ndërtimi i nënstacionit 400 kV Fier'"', të ndryshuar.....	24403
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Xhavit Muça.....	24404
	Korrigjim gabimi material, në vendimin nr. 418, datë 23.7.2025, të Këshillit të Ministrave, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, 'Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit', të ndryshuar", botuar në Fletoren Zyrtare nr. 133, datë 25.7.2024.....	24404

VENDIM
Nr. 616, datë 29.10.2025

PËR PËRCAKTIMIN E ELEMENTEVE TË CILËSISË PËR KLASIFIKIMIN E STATUSIT EKOLOGJIK TË LUMENJVE, LIQENEVE, UJËRAVE TRANZITORE, UJËRAVE BREGDETARE DHE TRUPAVE UJORË SIPËRFAQËSORË ARTIFICIALË DHE TEPËR TË MODIFIKUAR, KLASIFIKIMIN E STATUSIT EKOLOGJIK TË TYRE, SI DHE KËRKESAVE PËR KRYERJEN E ANALIZËS SË KARAKTERISTIKAVE DHE VLERËSIMIN E NDIKIMIT TË AKTIVITETIT NJERËZOR NË STATUSIN E UJËRAVE SIPËRFAQËSORE PËR ÇDO BASEN LUMOR OSE LIQENOR[1]

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 20, pika 2, e 27, pika 3, të ligjit nr. 29/2024, "Për burimet ujore", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesave për kryerjen e analizës së karakteristikave dhe vlerësimin e ndikimit të aktivitetit njerëzor në statusin e ujërave sipërfaqësore, përcaktimin e elementeve të cilësisë dhe klasifikimit të statusit ekologjik të trupave ujorë sipërfaqësorë, përcaktimin e cilësisë ekologjike shumë të mirë, të mirë dhe mesatare të ujërave sipërfaqësore, përcaktimin e kritereve të potencialit ekologjik shumë të mirë, të mirë dhe mesatar të një trupi ujor tepër të modifikuar ose artificial, si dhe miratimin e procedurës për përcaktimin e standardeve të cilësisë kimike, sipas parashikimeve të këtij vendimi.

2. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (në vijim "AMBU") kryen analizën e karakteristikave (në vijim "karakterizimin") fillestare të trupave ujorë sipërfaqësorë për çdo basen apo rajon baseni lumor, sipas rastit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në shtojcën I, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. AMBU-ja kryen vlerësimin e ndikimit të aktivitetit njerëzor në statusin e trupave ujorë sipërfaqësorë, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në shtojcën II, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Elementet e cilësisë për klasifikimin e statusit ekologjik të lumenjve të liqeneve, ujërave tranzitore dhe ujërave bregdetare përcaktohen në shtojcën III, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Elementet e cilësisë, të përcaktuara në shtojcën III, të këtij vendimi, do të aplikohen njësoj edhe në rastin e trupave ujorë artificialë ose tepër të modifikuar, vetëm në rastet kur këta të fundit përngjajnë me trupat ujorë natyrorë, të specifikuar në pikën 4 të këtij vendimi.

6. Parashikimet e përgjithshme lidhur me klasifikimin e statusit ekologjik të lumenjve, liqeneve, ujërave tranzitore dhe ujërave bregdetare përcaktohen në shtojcën IV, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

7. Parashikimet specifike të statusit ekologjik shumë të mirë, të mirë dhe mesatar të lumenjve, liqeneve, ujërave tranzitore dhe ujërave bregdetare lidhur me elementet biologjike, hidromorfologjike dhe fiziko-kimike të cilësisë përcaktohen në shtojcën V, që është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

8. Parashikimet specifike të statusit ekologjik shumë të mirë, të mirë dhe mesatar të trupave ujorë tepër të modifikuar ose artificialë lidhur me elementet biologjike, hidromorfologjike dhe fiziko-kimike të cilësisë përcaktohen në shtojcën VI, që është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

9. Standardet kimike të cilësisë së trupave ujorë sipërfaqësorë përcaktohen sipas procedurës të parashikuar në shtojcën VII, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

10. Për efekt të zbatimit të këtij vendimi lidhur me karakterizimin e trupave ujorë do të përdoret sistemi A, sipas shtojcës I, deri në momentin kur të sigurohen të dhënat e nevojshme dhe të mjaftueshme për të përdorur sistemin B.

[1] Ky vendim është përafruar pjesërisht me:
- direktivën 2000/60/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 23 tetor 2000, "Për krijimin e një kuadri për veprimin e komunitetit në fushën e politikës së ujërave", të ndryshuar. Numri CELEX 32000L0060, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 327, datë 22.12.2000, faqe 1–73.

11. Në vendimin nr. 1015, datë 16.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Ujore, të planeve të menaxhimit të baseneve ujore dhe të planeve të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet", bëhen këto ndryshime:

a) Në shkronjën "b", të pikës 1, të kreut 1, të shtojcës II, fjalët "... e ujërave sipërfaqësore ..." hiqen;

b) Pikat 1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe 1.5, të aneksit I; pikat 1.1 dhe 1.2 në përmbledhjen e aneksit 5, dhe nënpikat 1.1 dhe 1.2, të pikës 1, "Statusi i ujërave sipërfaqësore", të aneksit 5, pjesë e shtojcës III, shfuqizohen.

12. Ngarkohen Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

SHTOJCA I
KËRKESAT PËR KARAKTERIZIMIN E TRUPAVE UJORË SIPËRFAQËSORË TË BASENEVE LUMORE

1. KARAKTERIZIMI I TRUPAVE UJORË SIPËRFAQËSORË

1.1. AMBU-ja identifikon vendndodhjen dhe kufijtë e trupave ujorë sipërfaqësorë dhe kryen karakterizimin fillestar të tyre, në përputhje me metodologjinë në vijim. AMBU-ja mund të grupojë disa trupa ujorë sipërfaqësorë, me qëllim karakterizimin fillestar.

1.2. Trupat ujorë sipërfaqësorë, brenda një baseni lumor, klasifikohen në njërën prej kategorive të trupave ujorë sipërfaqësorë të mëposhtëm:

- Lumenj;
- Liqene;
- Ujëra tranzitore;
- Ujëra bregdetare;
- Trupa ujorë sipërfaqësorë artificialë;
- Trupa ujorë sipërfaqësorë tepër të modifikuar.

1.3. Për secilën prej kategorive të ujërave sipërfaqësore përcaktohen tipat e trupave ujorë sipërfaqësorë, brenda basenit lumor. Këta tipa përcaktohen duke përdorur sistemin A ose sistemin B, siç përcaktohet në tabelat 1–8.

1.4. Nëse përdoret sistemi A, trupat ujorë sipërfaqësorë, brenda basenit lumor (lumenj, liqene, trupa ujorë artificialë dhe tepër të modifikuar), klasifikohen fillimisht në rajonin ekologjik Dinarik të Ballkanit Perëndimor ose (ujërat bregdetare dhe kalimtare) në rajonin ekologjik të detit Mesdhe. Trupat ujorë, brenda këtyre rajoneve ekologjike (paraqitur në figurën 1 më poshtë), përcaktohen sipas tipit të trupit ujor, në përputhje me parashikimet e përshkruara në tabelat 1, 3, 5 dhe 7.

1.5. Nëse përdoret sistemi B (me faktorë të detyrueshëm dhe jo të detyrueshëm), i parashtruar në tabelat 2, 4, 6 dhe 8, duhet të arrihet të paktën i njëjti nivel diferencimi, si në rastin kur do të përdorej sistemi A. Trupat ujorë sipërfaqësorë, brenda basenit lumor, diferencohen në bazë të vlerave të përshkruesve të detyrueshëm. Këta përshkrues të detyrueshëm apo kombinimi i tyre mundësojnë përcaktimin e saktë të kushteve biologjike, reference specifike për çdo tip trupi ujor.

1.6. Për trupat ujorë artificialë dhe tepër të modifikuar, diferencimi bëhet në përputhje me përshkruesit e kategorisë së trupit ujor, me të cilin këta trupa ujorë ngjasojnë më shumë.

1.7. AMBU-ja publikon hartën ose hartat (në format GIS) të vendndodhjeve gjeografike të këtyre tipave, sipas shkallës së diferencimit që kërkohet nga sistemi A, si pjesë përbërëse e planeve të menaxhimit të baseneve lumore përkatëse.

2. TIPAT E TRUPAVE UJORË SIPËRFAQËSORË

2.1. Lumenjtë

Tabela 1. *SISTEMI A*

Tipoligjia	Përshkruesit	
	Tipologjia e lartësisë (TL)	
Tipi	*Përshkrimi*	*Lartësia*
	e ulët	<200 m
	mesatare	200–800 m
	e lartë	> 800 m
	Tipologjia e madhësisë bazuar në zonën ujëmbajtëse (TZU)	
	Përshkrimi	*Madhësia*
	e vogël	10-100 km²
	mesatare	101–1.000 km²
	e madhe	1.001–10.000 km²
	shumë e madhe	> 10.000 km²
	Tipologjia e bazuar në gjeologji (TGj)	
	Përshkrimi	
	gëlqeror	
	silicor	
	organik	

Tabela 2. *SISTEMI B*

Karakterizimi alternativ	Faktorët fizikë dhe kimikë që mund të përcaktojnë karakteristikat e lumit apo pjesëve të lumit dhe, për rrjedhojë, strukturën dhe përbërjen biologjike të popullatës
Faktorët e detyrueshëm	lartësia gjerësia gjatësia gjeologjia madhësia
Faktorët jo të detyrueshëm	largësia nga burimi energjia e rrjedhës (funksion i prurjes dhe i pjerrësisë) gjerësia mesatare e ujit thellësia mesatare e ujit pjerrësia mesatare e ujit forma dhe trajta e shtratit kryesor të lumit kategoria e prurjes së lumit forma e luginës transporti i mbetjeve të ngurta aftësia për të neutralizuar acidin përbërja mesatare e substratit klorur

Karakterizimi alternativ	Faktorët fizikë dhe kimikë që mund të përcaktojnë karakteristikat e lumit apo pjesëve të lumit dhe, për rrjedhojë, strukturën dhe përbërjen biologjike të popullatës
Faktorët e detyrueshëm	lartësia gjerësia gjatësia gjeologjia madhësia
	diapazoni i temperaturës së ajrit temperatura mesatare e ajrit reshjet

2.2. Liqenet

Tabela 3. *SISTEMI A*

Tipologjia	Përshkruesit	
Tipi	*Tipologjia e lartësisë (TL)*	
	Përshkrimi	*Lartësia*
	e ulët	<200 m
	mesatare	200—800 m
	e lartë	> 800 m
	Tipologjia e thellësisë bazuar në thellësinë mesatare	
	Përshkrimi	*Thellësia*
	e cekët	<3 m
	mesatare	3–15 m
	e thellë	> 15 m
	Tipologjia e madhësisë bazuar në sipërfaqe	
	Përshkrimi	*Sipërfaqja*
	e vogël	0,5–1 km²
	mesatare	1–10 km²
	e madhe	10–100 km²
	shumë e madhe	> 100 km²
	Tipologjia e bazuar në gjeologji	
	Përshkrimi	
	gëlqeror	
	silicor	
	organik	

Tabela 4. *SISTEMI B*

Karakterizimi alternativ	Faktorët fizikë dhe kimikë që mund të përcaktojnë karakteristikat e liqenit dhe, për rrjedhojë, strukturën dhe përbërjen biologjike të popullatës
Faktorët e detyrueshëm	lartësia gjerësia gjatësia thellësia gjeologjia madhësia
Faktorët jo të detyrueshëm	thellësia mesatare e trupit ujor forma e liqenit koha e qëndrimit temperatura mesatare e ajrit diapazoni i temperaturës së ajrit karakteristikat e përziera (për shembull monomike, dimike, polimike) kapaciteti acid-neutralizues përmbajtja e lëndëve ushqyese përbërja mesatare e substratit luhatja e nivelit të ujit

2.3. Ujërat tranzitore

Tabela 5. *SISTEMI A*

Tipologjia	Përshkruesit	
Tipi	*Bazuar në kripësinë mesatare vjetore*	
	Përshkrimi	*Vlera*
	ujërat e ëmbla	< 0,5 ‰
	oligohaline	0,5 deri në < 5 ‰
	mezohaline	5 deri në 18‰
	polihaline	18 deri në 30‰
	euhaline	30 deri në 40‰
	Bazuar në diapazonin baticor mesatar	
	Përshkrimi	*Diapazoni*
	mikrobaticor	<2 m
	mezobaticor	2–4 m
	makrobaticor	> 4 m

Tabela 6. *SISTEMI B*

Karakterizimi alternativ	Faktorët fizikë dhe kimikë që mund të përcaktojnë karakteristikat e liqenit dhe, për rrjedhojë, strukturën dhe përbërjen biologjike të popullatës
Faktorët e detyrueshëm	gjerësia gjatësia diapazoni baticor kripësia
Faktorët jo të detyrueshëm	thellësia shpejtësia e rrymës ekspozimi i valëve koha e qëndrimit temperatura mesatare e ujit karakteristikat e përziera turbullira përbërja mesatare e substratit forma diapazoni i temperaturës së ujit

2.4. Ujërat bregdetare

Tabela 7. *SISTEMI A*

Tipologjia	Përshkruesit	
Tipi	*Bazuar në kripësinë mesatare vjetore*	
	Përshkrimi	*Vlera*
	ujëra të ëmbla	< 0.5 ‰
	oligohaline	0.5 deri në < 5 ‰
	mezohaline	5 deri në < 18 ‰
	det polihalin	18 deri në < 35 ‰
	det euhalin	35 deri në < 40 ‰
	Bazuar në thellësinë mesatare	
	Përshkrimi	*Thellësia*
	ujëra të cekëta	<30 m
	ujëra mesatare	30–200 m
	ujëra të thella	> 200 m

Tabela 8. *SISTEMI B*

Karakterizimi alternativ	Faktorët fizikë dhe kimike që mund të përcaktojnë karakteristikat e liqenit dhe, për rrjedhojë, strukturën dhe përbërjen biologjike të popullatës
Faktorët e detyrueshëm	gjerësia gjatësia amplituda e baticës kripësia
Faktorët jo të detyrueshëm	shpejtësia e rrymës ekspozimi i valëve temperatura mesatare e ujit karakteristikat e përziera turbullira koha e qëndrimit (e gjireve të mbyllura) përbërja mesatare e substratit diapazoni i temperaturës së ujit

3. PËRCAKTIMI I KUSHTEVE REFERENCE SPECIFIKE PËR TIPAT E TRUPAVE UJORË SIPËRFAQËSORË

3.1. Për çdo trup ujor të karakterizuar në përputhje me pikën 1, të kësaj shtojce përcaktohen:

a) kushtet hidromorfologjike dhe fiziko-kimike specifike për tipin, që përfaqësojnë vlerat e elementeve hidromorfologjike dhe fiziko-kimike të cilësisë, të përshkruara në pikën 2, të kësaj shtojce, vetëm për ata trupa ujorë, të klasifikuar me status ekologjik shumë të mirë, të përcaktuar në përputhje me elementet e cilësisë dhe përkufizimet normative në shtojcave III, IV dhe V, të këtij vendimi;

b) kushtet biologjike reference specifike për tipin e trupit ujor, duke pasur parasysh vlerat e elementeve biologjike të cilësisë, të specifikuara për atë tip trupi ujor sipërfaqësor, të klasifikuar me status ekologjik shumë të mirë, të përcaktuar në përputhje me elementet e cilësisë dhe përkufizimet normative në shtojcat III, IV dhe V, të këtij vendimi.

3.2. Në rastin e trupave ujorë sipërfaqësorë artificialë ose tepër të modifikuar, si referencë për statusin ekologjik shumë të mirë, do të përdoret potenciali ekologjik maksimal, i klasifikuar në përputhje me parashikimet e shtojcës VI, të këtij vendimi. Vlera e potencialit ekologjik maksimal, për çdo trup ujor, do të rishikohet çdo 6 vjet.

3.3. Përcaktimi i kushteve specifike, për çdo tip trupi ujor, për qëllim të nënpikave 3.1 dhe 3.2, të kësaj pike, mund të kryhet me metodën hapësinore apo me modelim ose përmes kombinimit të tyre. Kur përdorimi i këtyre metodave nuk është i mundur, AMBU-ja mund të mbështetet në gjykimin profesional të ekspertëve të fushës. Në përcaktimin e statusit ekologjik shumë të mirë, lidhur me përqendrimet e ndotësve të veçantë, kufijtë e diktimit do të jenë ato që mund të arrihen në përputhje me teknikat e disponueshme, në kohën kur këto kushte reference specifike për tipin janë përcaktuar dhe që bazohen në të dhënat e niveleve për një komponim të caktuar (pra nga monitorimet/ analizat që janë bërë sa arrin vlera mesatare e diktimit të këtij parametri), përveç përputhjes me teknikat.

3.4. AMBU-ja, për kushtet biologjike reference specifike për tipat e trupave ujorë, të përcaktuara me metodën hapësinore, krijon një rrjet reference për çdo tip trupi ujor sipërfaqësor. Rrjeti duhet të

përmbajë një sërë vendndodhjesh me status shumë të mirë për të siguruar nivelin e duhur të besueshmërisë së vlerave të kushteve reference, duke pasur parasysh ndryshueshmërinë e vlerave të elementeve të cilësisë, që përkojnë me statusin ekologjik shumë të mirë, për atë tip trupi ujor sipërfaqësor, si dhe teknikat e modelimit që do të përdoren sipas përcaktimeve të nënpikës 3.5.

3.5. Kushtet biologjike reference, specifike për tipin e trupit ujor, të përcaktuara nëpërmjet modelimit, mund të identifikohen duke përdorur modelet parashikuese ose modele që rikrijojnë të shkuarën, bazuar në të dhëna historike. Modelet mbështeten në të dhënat historike, paleologjike dhe të dhëna të tjera dhe duhet të paraqesin një nivel besueshmërie të mjaftueshëm rreth vlerave për kushtet reference, duke siguruar se kushtet e përcaktuara janë në përputhje dhe të vlefshme për çdo tip trupi ujor sipërfaqësor.

3.6. Në rastet kur nuk është i mundur përcaktimi i kushteve reference të besueshme, specifike për tipin e trupit ujor, për një element të cilësisë, për shkak të shkallës së lartë të ndryshueshmërisë natyrore të atij elementi, që vjen jo vetëm si rezultat i ndryshimeve stinore, atëherë ky element mund të përjashtohet nga vlerësimi i statusit ekologjik. Në çdo rast, në vlerësimin e cilësisë duhet të merret në konsideratë lloji i elementit dhe pesha e tij, si dhe fakti nëse ka ose jo parametra të tjerë që luajnë rol të ngjashëm apo japin informacion për këtë vlerësim. AMBU-ja parashtron arsyet për këtë përjashtim në planin e menaxhimit të basenit lumor përkatës.

SHTOJCA II
IDENTIFIKIMI I PRESIONEVE DHE VLERËSIMI I NDIKIMIT TË AKTIVITETIT NJERËZOR

1. IDENTIFIKIMI I PRESIONEVE

AMBU-ja mbledh dhe ruan informacionet për llojet dhe magnitudën e presioneve antropogjene domethënëse, të cilat mund të prekin trupat ujorë sipërfaqësorë të çdo baseni lumor, veçanërisht për:

1.1. Vlerësimin dhe identifikimin e ndotjes pikësore të konsiderueshme, veçanërisht të shkaktuar nga ato substanca që do të përcaktohen në përputhje me parashikimet e pikës 2, të nenit 67, të pikës 3, të nenit 75, dhe të pikës 3, të nenit 80, të ligjit nr. 29/2024, "Për burimet ujore", të ndryshuar, të cilat gjenerohen nga veprimtaria urbane, industriale, bujqësore dhe instalime apo veprimtari të tjera, të identifikuara, në kuadër të legjislacionit për burimet ujore dhe mbrojtjen mjedisore;

1.2. Vlerësimin dhe identifikimin e ndotjeve jopikësore të konsiderueshme, veçanërisht të shkaktuara nga ato substanca, që përcaktohen në përputhje me parashikimet e pikës 2, të nenit 67, të pikës 3, të nenit 75, dhe të pikës 3, të nenit 80, të ligjit nr. 29/2024, "Për burimet ujore", të ndryshuar, të cilat gjenerohen nga veprimtaria urbane, industriale, bujqësore dhe instalime apo veprimtari të tjera, të identifikuara në kuadër të legjislacionit për burimet ujore dhe mbrojtjen mjedisore;

1.3. Vlerësimin dhe identifikimin e vendndodhjeve të nxjerrjes së ujit nga veprimtari urbane, industriale, bujqësore dhe përdorimet e tjera, duke përfshirë edhe luhatjet stinore, kërkesën e përgjithshme vjetore dhe humbjet e ujit në sistemet e shpërndarjes;

1.4. Vlerësimin dhe identifikimin e ndikimit të rregullave të rëndësishme të rrjedhjes së ujit, duke përfshirë dhe transferimin e ujit dhe ndryshimin e tij për karakteristikat e përgjithshme të rrjedhjes dhe për balancat ujore;

1.5. Identifikimin e ndryshimeve morfologjike të konsiderueshme të trupave ujorë, përfshirë edhe vlerësimin e ndikimeve antropogjene, të cilat mund të shkaktojnë dëmtimin e shtratit të lumit të tilla, si nxjerrja e inerteve lumore, prita ujore, diga etj.;

1.6. Vlerësimin dhe identifikimin e ndikimeve të tjera antropogjene në statusin e ujërave sipërfaqësore;

1.7. Vlerësimin e veçorive të përdorimit të tokës, duke përfshirë identifikimin e zonave urbane, industriale, bujqësore e, kur shihet e përshtatshme, edhe të zonave të peshkimit e të atyre pyjore.

2. VLERËSIMI I NDIKIMIT

2.1. AMBU-ja kryen një vlerësim lidhur me aftësinë e trupit ujor për të përballuar presionet e identifikuara, në përputhje me pikën 1, të kësaj shtojce, në raport me statusin e trupit ujor sipërfaqësor përkatës.

2.2. Për vlerësimin e mundësive që ka trupi ujor sipërfaqësor, brenda basenit lumor, për të mos arritur objektivat e cilësisë mjedisore, të

përcaktuara për atë tip trupi ujor, përdoret informacioni i grumbulluar sipas pikës 1, të kësaj shtojce, apo çdo informacion tjetër, përfshirë edhe të dhënat e monitorimit mjedisor. Për të plotësuar këtë vlerësim mund të përdoren edhe teknikat e modelimit.

2.3. Për trupat ujorë të identifikuar në rrezik për mospërmbushje të objektivave të cilësisë mjedisore, AMBU-ja kryen karakterizimin e mëtejshëm, kur shihet e përshtatshme për të përmirësuar, si programin e monitorimit të ujërave, ashtu edhe programet e masave të planeve të menaxhimit të baseneve lumore.

SHTOJCA III
ELEMENTET E CILËSISË PËR KLASIFIKIMIN E STATUSIT EKOLOGJIK

1. ELEMENTET E CILËSISË PËR KLASIFIKIMIN E STATUSIT EKOLOGJIK TË LUMENJVE

1.1 . Elementet e cilësisë për klasifikimin e statusit ekologjik të lumenjve përbëhen nga:

1.1.1. Elementet biologjike:

a) përbërja dhe larmia e florës ujore;

b) përbërja dhe larmia e faunës bentike jovertebrore;

c) përbërja, larmia dhe struktura moshore e faunës së peshqve.

1.1.2. Elementet hidromorfologjike, që mbështesin elementet biologjike:

a) regjimi hidrologjik:

i. sasia dhe dinamika e rrjedhës ujore;

ii. lidhja me trupat ujorë nëntokësorë.

b) vijimësia e lumit;

c) kushtet morfologjike;

ç) thellësia dhe variacioni i lumit;

d) struktura dhe nënshtresa e shtratit të lumit;

dh) struktura e zonës së bregut.

1.1.3. Elementet kimike dhe fiziko-kimike, që mbështesin elementet biologjike:

a) të përgjithshme:

i. kushtet termale;

ii. kushtet e oksigjenimit;

iii. kripësia;

iv. statusi i acidifikimit;

v. gjendja e lëndëve ushqyese.

b) ndotës të veçantë:

i. ndotja nga të gjitha substancat prioritare, që janë identifikuar se shkarkohen në trupin ujor;

ii. ndotja nga substanca të tjera që janë identifikuar se shkarkohen në trupin ujor në sasi të konsiderueshme.

2. ELEMENTET E CILËSISË PËR KLASIFIKIMIN E STATUSIT EKOLOGJIK TË LIQENEVE

2.1. Elementet e cilësisë për klasifikimin e statusit ekologjik të liqeneve përbëhen nga:

2.1.1. Elementet biologjike:

a) përbërja, larmia dhe biomasa e fitoplanktonit;

b) përbërja dhe larmia e florës tjetër ujore;

c) përbërja dhe larmia e faunës bentike jovertevrore;

ç) përbërja, larmia dhe struktura moshore e faunës së peshqve.

2.1.2. Elementet hidromorfologjike, që mbështesin elementet biologjike:

a) regjimi hidrologjik:

i. sasia dhe dinamika e rrjedhës ujore;

ii. koha e qëndrimit;

iii. lidhja me trupat ujorë nëntokësorë.

b) kushtet morfologjike:

i. variacioni i thellësisë së liqenit;

ii. sasia, struktura dhe nënshtresa e shtratit të liqenit;

iii. struktura e bregut të liqenit.

2.1.3. Elementet kimike dhe fiziko-kimike, që mbështesin elementet biologjike:

a) të përgjithshme:

i. transparenca;

ii. kushtet termale;

iii. kushtet e oksigjenimit;

iv. kripësia;

v. statusi i acidifikimit;

vi. gjendja e lëndëve ushqyese.

b) ndotës të veçantë:

i. ndotja nga të gjitha substancat prioritare, që janë identifikuar se shkarkohen në trupin ujor;

ii. ndotja nga substanca të tjera, që janë identifikuar se shkarkohen në trupin ujor në sasi të konsiderueshme.

3. ELEMENTET E CILËSISË PËR KLASIFIKIMIN E STATUSIT EKOLOGJIK TË UJËRAVE TRANZITORE

3.1 .Elementet e cilësisë për klasifikimin e statusit ekologjik të ujërave tranzitore përbëhen nga:

3.1.1. Elementet biologjike:

a) përbërja, larmia dhe biomasa e fitoplanktonit;

b) përbërja dhe larmia e florave të tjera ujore;

c) përbërja dhe larmia e faunës bentike jovertevrore;

ç) përbërja, larmia dhe struktura moshore e faunës së peshqve.

3.1.2. Elementet hidromorfologjike, që mbështesin elementet biologjike:

a) kushtet morfologjike:

i. variacionet e thellësisë;

ii. sasia, struktura dhe nënshtresa e shtratit;

iii. struktura e zonës ndërbaticore;

b) regjimi baticor:

i. rrjedha e ujërave të ëmbla;

ii. ekspozimi i valëve.

3.1.3. Elementet kimike dhe fiziko-kimike, që mbështesin elementet biologjike:

a) të përgjithshme:

i. transparenca;

ii. kushtet termale;

iii. kushtet e oksigjenimit;

iv. kripësia;

v. gjendja e lëndëve ushqyese.

b) ndotës të veçantë:

i. ndotja nga të gjitha substancat prioritare, që janë identifikuar se shkarkohen në trupin ujor;

ii. ndotja nga substanca të tjera, të cilat janë identifikuar, që shkarkohen në trupin ujor në sasi të konsiderueshme.

4. ELEMENTET E CILËSISË PËR KLASIFIKIMIN E STATUSIT EKOLOGJIK TË UJËRAVE BREGDETARE

4.1 .Elementet e cilësisë për klasifikimin e statusit ekologjik të ujërave kalimtare përbëhen nga:

4.1.1. Elementet biologjike:

a) përbërja, larmia dhe biomasa e fitoplanktonit;

b) përbërja dhe larmia e florës të tjetra ujore;

c) përbërja dhe larmia e faunës bentike jovertevrore;

4.1.2. Elementet hidromorfologjike, që mbështesin elementet biologjike:

a) kushtet morfologjike:

i. variacionet e thellësisë;

ii. struktura dhe nënshtresa e shtratit të bregdetit;

iii. struktura e zonës ndërbaticore.

b) regjimi baticor:

i. drejtimi i rrymave dominuese;

ii. ekspozimi i valëve.

4.1.3. Elementet kimike dhe fiziko-kimike, që mbështesin elementet biologjike:

a) të përgjithshme:

i. transparenca;

ii. kushtet termale;

iii. kushtet e oksigjenimit;

iv. kripësia;

v. gjendja e lëndëve ushqyese.

b) ndotës të veçantë:

i. ndotja nga të gjitha substancat prioritare, që janë identifikuar se shkarkohen në trupin ujor;

ii. ndotja nga substanca të tjera, që janë identifikuar se shkarkohen në trupin ujor në sasi të konsiderueshme.

SHTOJCA IV

PËRKUFIZIMET E PËRGJITHSHME NORMATIVE PËR KLASIFIKIMIN E STATUSIT EKOLOGJIK TË LUMENJVE, LIQENEVE, UJËRAVE TRANZITORE DHE UJËRAVE BREGDETARE

Elementi	Statusi shumë i mirë	Statusi i mirë	Statusi mesatar
Të përgjithshme	Nuk ka ose ka shumë pak ndryshime antropogjene të vlerave të elementeve fiziko-kimike dhe hidromorfologjike të cilësisë për tipin e trupit ujor sipërfaqësor, krahasuar me vlerat tipike për tipin e trupit ujor në kushte natyrore.	Vlerat e elementeve biologjike të cilësisë për tipin e trupit ujor sipërfaqësor paraqesin nivele të ulëta devijimi për shkak të veprimtarive antropogjene, por që devijojnë lehtësisht, krahasuar me vlerat tipike të tipit të trupit ujor	Vlerat e elementeve biologjike të cilësisë për tipin e trupit ujor sipërfaqësor devijojnë mesatarisht nga vlerat tipike për tipin e trupit ujor sipërfaqësor në kushte natyrore. Vlerat paraqesin devijim mesatar për shkak të veprimtarive antropogjene dhe devijojnë në mënyrë të

	Vlerat e elementeve biologjike të cilësisë për trupin ujor sipërfaqësor pasqyrojnë vlerat tipike të tipit të trupit ujor në kushte natyrore dhe nuk paraqesin asnjë devijim ose shumë pak devijime. Këto janë kushtet dhe komunitetet specifike për llojin.	sipërfaqësor në kushte natyrore.	konsiderueshme, krahasuar me vlerat në kushtet e statusit të mirë.

Ujërat me status nën kategorinë mesatare klasifikohen si ujëra me status të dobët ose të keq.

Ujërat që shfaqin ndryshime madhore të vlerave të elementeve biologjike të cilësisë për tipin e trupit ujor sipërfaqësor, ku komunitetet biologjike devijojnë në mënyrë të konsiderueshme, krahasuar me ato të tipit të trupit ujor sipërfaqësor në kushte natyrore, klasifikohen me status të dobët.

Ujërat që shfaqin ndryshime madhore të vlerave biologjike të cilësisë për tipin e trupit ujor sipërfaqësor, ku mungon një pjesë e madhe e komuniteteve biologjike tipike për atë tip trupi ujor sipërfaqësor në kushte natyrore, klasifikohen me status të keq.

SHTOJCA V

1. PËRKUFIZIMET E STATUSIT EKOLOGJIK SHUMË TË MIRË, TË MIRË DHE MESATAR TË LUMENJVE PËR ELEMENTET BIOLOGJIKE, HIDROMORFOLOGJIKE DHE FIZIKO-KIMIKE TË CILËSISË

Elementi	Statusi shumë i mirë	Statusi i mirë	Statusi mesatar
Elementet biologjike të cilësisë			
Fitoplanktoni	Përbërja taksonomike e fitoplanktonit përkon plotësisht ose thuajse plotësisht me kushtet natyrore. Abondanca mesatare e fitoplanktonit përkon tërësisht me kushtet fiziko-kimike specifike për llojin dhe nuk është në atë nivel sa të ndryshojë në mënyrë domethënëse kushtet specifike për llojin për transparencën. Frekuenca dhe intensiteti i lulëzimeve të planktonit janë të njëjta me kushtet kushtet fiziko-kimike specifike për llojin.	Ka ndryshime të vogla në përbërjen dhe abondancën e taksoneve të fitoplanktonit, krahasuar me komunitetet specifike për llojin. Këto ndryshime nuk tregojnë për rritjen e përshpejtuar të algave, që sjell dëmtim të padëshiruar të ekuilibrit të organizmave të pranishme në trupin ujor ose të cilësisë fiziko-kimike të ujit ose të sedimentit. Mund të ketë rritje të lehtë të frekuencës dhe intensitetit të lulëzimeve të planktonit specifike për llojin.	Përbërja e taksoneve të planktonit ndryshon mesatarisht nga komunitetet specifike për llojin. Abondanca ndryshon në mënyrë të moderuar dhe në nivele të tilla që mund të krijojë devijime të padëshiruara në vlerat e elementeve të tjera biologjike dhe fiziko-kimike të cilësisë. Mund të ketë rritje të moderuar të frekuencës dhe intensitetit të lulëzimeve të planktonit. Mund të ketë lulëzime persistente gjatë muajve të verës.
Makrofitet dhe fitobentosi	Përbërja taksonomike përkon plotësisht ose thuajse plotësisht me kushtet natyrore. Nuk ka ndryshime të dukshme të abondancës	Ka ndryshime të vogla të përbërjes dhe abondancës së taksoneve të makrofiteve dhe fitobentosit, krahasuar me komunitetet specifike për llojin. Këto ndryshime nuk paraqesin rritje të përshpejtuar të fitobentosit	Përbërja e taksoneve të makrofiteve dhe të fitobentosit ndryshon në mënyrë të moderuar nga ato specifike për llojin dhe ka devijime të konsiderueshme, krahasuar me kushtet kur statusi është i mirë.

	mesatare të makrofiteve dhe fitobentosit.	ose formave më të zhvilluara të jetës bimore, që sjellin shqetësime të padëshiruara të ekuilibrit të organizmave të pranishëm në trupin ujor ose në cilësinë fiziko-kimike të ujit ose të sedimentit. Komuniteti i fitobentosit nuk ndikohet në mënyrë të parikthyeshme nga grupime bakteriale të pranishme, si rezultat i veprimtarive antropogjene.	Ka ndryshime të moderuara të abondancës mesatare të makrofiteve dhe të fitobentosit. Komuniteti i fitobentosit mund të ndikohet dhe në disa zona mund edhe të zhvendoset nga grupime bakteriale të pranishme, si rezultat i veprimtarive antropogjene.
Fauna e invertebrorëve bentikë	Përbërja dhe abondanca taksonomike përkon plotësisht ose thuajse plotësisht me kushtet natyrore. Raporti midis taksoneve sensitive dhe atyre josensitive nuk shfaq asnjë shenjë devijimi nga nivelet natyrore. Niveli i diversitetit të taksoneve invertebrore nuk paraqet asnjë shenjë devijimi nga nivelet e natyrore.	Ka ndryshime të vogla në përbërjen dhe abondancën e taksoneve invertebrore nga komunitetet specifike për llojin. Raporti midis taksoneve sensitive dhe atyre josensitive, shfaq shenja të vogla devijimi nga nivelet specifike për llojin. Niveli i diversitetit të taksoneve invertebrore shfaq shenja të vogla devijimi nga nivelet e specifike për llojin.	Përbërja dhe abondanca e taksoneve invertebrore ndryshon mesatarisht nga komunitetet specifike për llojin. Mungojnë tërësisht grupet kryesore taksonomike të komunitetit specifik për llojin. Raporti midis taksoneve sensitive dhe atyre josensitive është më i ulët se niveli specifik për llojin dhe shumë më i ulët se niveli në statusin e mirë.
Fauna e peshqve	Përbërja dhe abondanca e llojeve përkon plotësisht ose thuajse plotësisht me kushtet natyrore. Janë të pranishme të gjitha llojet sensitive specifike për llojin. Strukturat moshore të komuniteteve të peshqve shfaqin shenja të vogla të ndikimit nga veprimtaritë antropogjene dhe nuk shfaqin mungesë riprodhimi apo zhvillimi të ndonjë lloji veçantë.	Ka ndryshime të vogla në përbërje dhe abondancë, krahasuar me komunitetet specifike për llojin për shkak të ndikimeve antropogjene në elementet fiziko-kimike dhe hidromorfologjike të cilësisë. Strukturat moshore të komuniteteve të peshqve shfaqin shenja shqetësimesh, për shkak të ndikimeve antropogjene në elementet fiziko-kimike dhe hidromorfologjike të cilësisë dhe në disa raste janë tregues të mungesës së riprodhimit dhe zhvillimit të ndonjë lloji të veçantë, deri në atë masë sa disa klasa moshore mund të mos jenë të pranishme.	Përbërja dhe abondanca e peshqve ndryshojnë në mënyrë të moderuar, krahasuar me komunitetet specifike për llojin për shkak të ndikimeve antropogjene në elementet e fiziko-kimike dhe hidromorfologjike të cilësisë. Struktura moshore e komuniteteve të peshqve shfaq shenja të mëdha të shqetësimeve antropogjene, deri në atë masë sa një pjesë e moderuar e llojeve specifike mungonjnë tërësisht ose kanë abondancë të ulët.
Elementet hidromorfologjike të cilësisë			
Regjimi hidrologjik	Sasia dhe dinamikat e rrjedhës dhe lidhja, si pasojë me ujërat nëntokësore	Kushtet në përputhje me arritjen e vlerave, të përcaktuara më lart për	Kushtet në përputhje me arritjen e vlerave, të

	reflektojnë plotësisht ose thuajse plotësisht me kushtet natyrore.	elementet biologjike të cilësisë.	përcaktuara më lart për elementet biologjike të cilësisë.
Vazhdimësia e lumit	Vazhdimësia e lumit nuk ndikohet nga veprimtaritë antropogjene dhe lejon migrimin natyror të organizmave ujorë dhe transportin e sedimenteve.	Kushtet në përputhje me arritjen e vlerave, të përcaktuara më lart për elementet biologjike të cilësisë.	Kushtet në përputhje me arritjen e vlerave, të përcaktuara më lart për elementet biologjike të cilësisë.
Kushtet morfologjike	Tipologjia e kanaleve, variacionet e gjerësisë dhe thellësisë, shpejtësitë e prurjes, si dhe struktura dhe gjendja e zonës së bregut përkojnë plotësisht ose thuajse plotësisht me kushtet natyrore.	Kushtet në përputhje me arritjen e vlerave, të përcaktuara më lart për elementet biologjike të cilësisë.	Kushtet në përputhje me arritjen e vlerave, të përcaktuara më lart për elementet biologjike të cilësisë.
Kushtet fiziko-kimike të cilësisë (1)			
Kushtet e përgjithshme	Vlerat e elementeve fiziko-kimike përkojnë plotësisht ose thuajse plotësisht me kushtet natyrore. Përqendrimet e lëndëve ushqyese janë brenda diapazonit të kushteve natyrore. Nivelet e kripësisë, pH, bilancit të oksigjenit, kapacitetit acid-netrualizues dhe temperaturës nuk shfaqin shenja të ndikimeve antropogjene dhe janë brenda diapazonit diapazonit të kushteve natyrore.	Temperatura, bilanci i oksigjenit, pH, kapaciteti acid-neutralizues dhe kripësia nuk i tejkalojnë nivelet e diapazonit të përcaktuar, me qëllim që të sigurohet funksionimi i ekosistemit specifik për llojin dhe arritja e vlerave, të përcaktuara më sipër për elementet biologjike të cilësisë. Përqendrimet e lëndëve ushqyese nuk i tejkalojnë nivelet e përcaktuara me qëllim që të sigurohet funksionimi i ekosistemit dhe arritja e vlerave, të përcaktuara më sipër për elementet biologjike të cilësisë.	Kushtet në përputhje me arritjen e vlerave, të përcaktuara më lart për elementet biologjike të cilësisë.
Ndotësit sintetikë specifikë	Përqendrimet janë në vlera thuajse zero dhe të paktën nën kufijtë e diktimit të teknikave më të avancuara analitike në përdorim të përgjithshëm.	Përqendrimet nuk i tejkalojnë standardet e përcaktuara në përputhje me procedurën për përcaktimin e standardeve kimike të cilësisë, të parashikuar në përputhje me procedurën e detajuar në shtojcën VII, të këtij vendimi(2), pa ndikuar në nxjerrjen në treg të produkteve të mbrojtjes së bimëve dhe biocideve (< SCM)	Kushtet në përputhje me arritjen e vlerave, të përcaktuara më lart për elementet biologjike të cilësisë.
Ndotësit josintetikë specifikë	Përqendrimet janë brenda diapazonit tipik për kushtet natyrore (nivelet e natyrore = nn). (1)	Përqendrimet nuk i tejkalojnë standardet e përcaktuara në përputhje me procedurën për	Kushtet në përputhje me arritjen e vlerave, të përcaktuara më lart për elementet biologjike të cilësisë.

		përcaktimin e standardeve të cilësisë kimike, të parashikuar në përputhje me procedurën e detajuar në shtojcën VII, të këtij vendimi[2], pa ndikuar në nxjerrjen në treg të produkteve të mbrojtjes së bimëve dhe biocideve (< SCM)	

[1] Shkurtimet e përdorura kanë këto kuptime: nn = niveli natyror; SCM = standardet e cilësisë mjedisore;
[2] Zbatimi i standardeve, që rrjedhin nga ky protokoll, nuk kërkon zvogëlimin e përqendrimeve të ndotjes nën nivelet natyrore (SCM > nn).

2. PËRKUFIZIMET E STATUSIT EKOLOGJIK SHUMË TË MIRË, TË MIRË DHE MESATAR TË LIQENEVE PËR ELEMENTET BIOLOGJIKE, HIDROMORFOLOGJIKE DHE FIZIKO-KIMIKE TË CILËSISË

Elementi	Statusi shumë i mirë	Statusi i mirë	Statusi mesatar
Elementet biologjike të cilësisë			
Fitoplanktoni	Përbërja taksonomike dhe abondanca e fitoplanktonit përkon plotësisht ose thuajse plotësisht me kushtet natyrore. Biomasa mesatare e fitoplanktonit përkon tërësisht me kushtet fiziko-kimike specifike për llojin dhe nuk është në atë nivel sa të ndryshojë në mënyrë domethënëse kushtet specifike për llojin për transparencën. Frekuenca dhe intensiteti i lulëzimeve të planktonit janë të njëjta me kushtet kushtet fiziko-kimike specifike për llojin.	Ka ndryshime të vogla në përbërjen dhe abondancën e taksoneve të fitoplanktonit, krahasuar me komunitetet specifike për llojin. Këto ndryshime nuk tregojnë për rritjen e përshpejtuar të algave, që sjell dëmtim të padëshiruar të ekuilibrit të organizmave të pranishme në trupin ujor ose të cilësisë fiziko-kimike të ujit ose të sedimentit. Mund të ketë rritje të lehtë të frekuencës dhe intensitetit të lulëzimeve të planktonit, specifike për llojin.	Përbërja e taksoneve të planktonit ndryshon mesatarisht nga komunitetet specifike për llojin. Abondanca ndryshon në mënyrë të moderuar dhe në nivele të tilla që mund krijojë devijime të padëshiruara në vlerat e elementeve të tjera biologjike dhe fiziko-kimike të cilësisë. Mund të ketë rritje të moderuar të frekuencës dhe intensitetit të lulëzimeve të planktonit. Mund të ketë lulëzime persistente gjatë muajve të verës.
Makrofitet dhe fitobentosi	Përbërja taksonomike e fitoplanktonit përkon plotësisht ose thuajse plotësisht me atë në kushte normale. Nuk ka ndryshime të dukshme të abondancës mesatare të makrofiteve dhe fitobentosit.	Ka ndryshime të vogla në përbërjen dhe abondancën e taksoneve të makrofiteve dhe fitobentosit, krahasuar me komunitetet specifike për llojin. Këto ndryshime nuk paraqesin rritje të përshpejtuar të fitobentosit ose formave më të zhvilluara të jetës bimore, që ndikojnë negativitsht në ekuilibrin e organizmave të pranishëm në trupin ujor ose në cilësinë fiziko-kimike të ujit apo të sedimentit.	Përbërja e taksoneve makrofite dhe fitobentike ndryshon në nivel mesatar nga komuniteti specifik për llojin dhe ka devijime të konsiderueshme, krahasuar me përbërjen në statusin e mirë. Ka ndryshime të moderuara të abondancës mesatare të makrofiteve dhe fitobentosit.

		Komuniteti fitobentik nuk ndikohet negativisht nga grupime bakteriale të pranishme për shkak të veprimtarisë antropogjene.	Komuniteti i fitobentosit mund të ndikohet dhe në disa zona, mund edhe të zhvendoset nga grupime bakteriale të pranishme, si rezultat i veprimtarive antropogjene.
Fauna e invertebrorëve bentikë	Përbërja dhe abondanca taksonomike përkon plotësisht ose thuajse plotësisht me kushtet natyrore. Raporti midis taksoneve sensitive dhe atyre josensitive nuk shfaq asnjë shenjë devijimi nga nivelet natyrore. Niveli i diversitetit të taksoneve invertebrore nuk paraqet asnjë shenjë devijimi nga nivelet e natyrore.	Ka ndryshime të vogla në përbërjen dhe abondancën e taksoneve invertebrore nga komunitetet specifike për llojin. Raporti midis taksoneve sensitive dhe atyre josensitive shfaq shenja të vogla devijimi nga nivelet specifike për llojin. Niveli i diversitetit të taksoneve invertebrore shfaq shenja të vogla devijimi nga nivelet e specifike për llojin.	Përbërja dhe abondanca e taksoneve invertebrore ndryshon mesatarisht nga komunitetet specifike për llojin. Mungojnë tërësisht grupet kryesore taksonomike të komunitetit specifik për llojin. Raporti midis taksoneve sensitive dhe atyre josensitive është më i ulët se niveli specifik për llojin dhe shumë më i ulët se niveli në statusin e mirë.
Fauna e peshqve	Përbërja dhe abondanca e llojeve përkon plotësisht ose thuajse plotësisht me kushtet natyrore. Janë të pranishme të gjitha llojet sensitive specifike për llojin. Strukturat moshore të komuniteteve të peshqve shfaqin shenja të vogla të ndikimit nga veprimtaritë antropogjene dhe nuk shfaqin mungesë riprodhimi apo zhvillimi të ndonjë lloji të veçantë.	Ka ndryshime të vogla në përbërje dhe abondancë, krahasuar me komunitetet specifike për llojin për shkak të ndikimeve antropogjene në elementet fiziko-kimike dhe hidromorfologjike të cilësisë. Strukturat moshore të komuniteteve të peshqve shfaqin shenja shqetësimesh, për shkak të ndikimeve antropogjene në elementet fiziko-kimike dhe hidromorfologjike të cilësisë dhe në disa raste janë tregues të mungesës së riprodhimit dhe të zhvillimit të ndonjë lloji të veçantë, deri në atë masë sa disa klasa moshore mund të mos jenë të pranishme.	Përbërja dhe abondanca e peshqve ndryshojnë në mënyrë të moderuar, krahasuar me komunitetet specifike për llojin për shkak të ndikimeve antropogjene në elementet e fiziko-kimike dhe hidromorfologjike të cilësisë. Struktura moshore e komuniteteve të peshqve shfaq shenja të mëdha të shqetësimeve antropogjene, deri në atë masë sa një pjesë e moderuar e llojeve specifike mungojnë tërësisht ose kanë abondancë të ulët.
Elementet hidromorfologjike të cilësisë			
Regjimi hidrologjik	Cilësia dhe dinamika e rrjedhës, niveli, koha e qëndrimit dhe ndërlidhja me ujërat nëntokësore reflektojnë plotësisht ose thuajse plotësisht kushtet natyrore.	Kushtet në përputhje me arritjen e vlerave të përcaktuara më lart për elementet biologjike të cilësisë.	Kushtet në përputhje me arritjen e vlerave, të përcaktuara më lart për elementet biologjike të cilësisë.
Kushtet morfologjike	Variacionet e thellësisë së liqenit, sasisë dhe struktura e substratit, si dhe struktura dhe kushtet e zonës së bregut	Kushtet në përputhje me arritjen e vlerave, të përcaktuara më lart për	Kushtet në përputhje me arritjen e vlerave, të përcaktuara më lart për

	të liqenit përkojnë plotësisht ose thuajse plotësisht me kushtet natyrore.	elementet biologjike të cilësisë.	elementet biologjike të cilësisë.
Elementet fiziko-kimike të cilësisë (1)			
Kushtet e përgjithshme	Vlerat e elementeve fiziko-kimike përkojnë plotësisht ose thuajse plotësisht me kushtet natyrore. Përqendrimet e lëndëve ushqyese janë brenda diapazonit të kushteve natyrore. Nivelet e kripësisë, pH, bilancit të oksigjenit, kapacitetit acid-netrualizues dhe temperaturës nuk shfaqin shenja të ndikimeve antropogjene dhe janë brenda diapazonit diapazonit të kushteve natyrore.	Temperatura, bilanci i oksigjenit, pH, kapaciteti acid-neutralizues dhe kripësia nuk i tejkalojnë nivelet e diapazonit të përcaktuar, me qëllim që të sigurohet funksionimi i ekosistemit specifik për llojin dhe arritja e vlerave të përcaktuara më sipër për elementet biologjike të cilësisë. Përqendrimet e lëndëve ushqyese nuk i tejkalojnë nivelet e përcaktuara me qëllim që të sigurohet funksionimi i ekosistemit dhe arritja e vlerave të përcaktuara më sipër për elementet biologjike të cilësisë.	Kushtet në përputhje me arritjen e vlerave, të përcaktuara më lart për elementet biologjike të cilësisë.
Ndotësit sintetikë specifikë	Përqendrimet janë në vlera thuajse zero dhe të paktën nën kufijtë e diktimit të teknikave më të avancuara analitike në përdorim të përgjithshëm.	Përqendrimet nuk i tejkalojnë standardet e përcaktuara në përputhje me procedurën për përcaktimin e standardeve kimike të cilësisë, të parashikuar në përputhje me procedurën e detajuar në shtojcën VII, të këtij vendimi(2), pa ndikuar në nxjerrjen në treg të produkteve të mbrojtjes së bimëve dhe biocideve (< SCM)	Kushtet në përputhje me arritjen e vlerave të përcaktuara më lart për elementet biologjike të cilësisë.
Ndotësit josintetikë specifikë	Përqendrimet janë brenda diapazonit tipik për kushtet natyrore (nivelet e natyrore = nn). (1)	Përqendrimet nuk i tejkalojnë standardet e përcaktuara, në përputhje me procedurën për përcaktimin e standardeve të cilësisë kimike, të parashikuar në përputhje me procedurën e detajuar në shtojcën VII, të këtij vendimi(2), pa ndikuar në nxjerrjen në treg të produkteve të mbrojtjes së bimëve dhe biocideve (< SCM)	Kushtet në përputhje me arritjen e vlerave të përcaktuara më lart për elementet biologjike të cilësisë.

(1) Shkurtimet e përdorura kanë këto kuptime: nn = niveli natyror; SCM = standardet e cilësisë mjedisore;

(2) Zbatimi i standardeve, që rrjedhin nga ky protokoll, nuk kërkon zvogëlimin e përqendrimeve të ndotjes nën nivelet natyrore (SCM > nn).

Sistemi koordinativ: KRGJSH
Projektimi: KRGJSH



VENDIM
Nr. 625, datë 29.10.2025

PËR SHPALLJEN E DISA ZONAVE ME PËRPARËSI ZHVILLIMIN E EKONOMISË MALORE NË BASHKINË ELBASAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 20/2025, "Për paketën e maleve", me propozimin e ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, Këshilli i Ministrave:

VENDOSI:

1. Shpalljen "Zonë me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore" në territorin e Bashkisë Elbasan të disa zonave, si më poshtë vijon:

a) Zonës nr. 1, Njësia Administrative Funar, me sipërfaqe 1 439, 89 (një mijë e katërqind e tridhjetë e nëntë presje tetëdhjetë e nëntë) ha, sipas hartës në sistemin KRRGJSH, të paraqitura mbi ortofoto;

b) Zonës nr. 2, Njësia Administrative Gjinar, me sipërfaqe 1 047, 74 (një mijë e dyzet e shtatë presje shtatëdhjetë e katër) ha, sipas hartës në sistemin KRRGJSH, të paraqitura mbi ortofoto;

c) Zonës nr. 3, Njësia Administrative Tregan, me sipërfaqe 398,1 (treqind e nëntëdhjetë e tetë pikë një) ha, sipas hartës në sistemin KRRGJSH, të paraqitura mbi ortofoto;

ç) Zonës nr. 4, Njësia Administrative Shushicë, me sipërfaqe 705,96 (shtatëqind e pesë presje nëntëdhjetë e gjashtë) ha, sipas hartës në sistemin KRRGJSH, të paraqitura mbi ortofoto.

2. Shtrirja, kufijtë pikat e hyrjes dhe të daljes së këtyre zonave përcaktohen në hartën treguese, sipas sistemit KRRGJSH, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Llojet e aktiviteteve që do të zhvillohen në këto zona janë:

a) të zhvillimit ekonomik;

b) të zhvillimit industrial;

c) të zhvillimit turistik.

4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit, Agjencia e Zhvillimit të Territorit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Bashkia Elbasan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

PLAN-VENDOSJA E ZONËS ZHVILLIMORE NR.1 (FUNAR)
SH - 1 : 25 000 (KRRGJSH)
SIPËRFAQJA = 1439,89 HA



Pika	X	Y
1	507405	4562429
2	507399	4563362
3	506438	4564332
4	506125	4564520
5	505823	4565498
6	504305	4565702
7	503978	4565835
8	503138	4565377
9	502111	4564345
10	502740	4564156
11	502900	4563751
12	502945	4563133
13	503685	4562845
14	503643	4562688
15	503087	4562250
16	503686	4561502
17	504065	4561532
18	504694	4561340
19	505057	4561967
20	506288	4562094

GRUPI PUNËS

Asim Sula Petrit Lamcja Hasan Idrizi Edlira Krraba Englantina Doko Gentiana Kerri Krisi Totoshi

PLAN-VENDOSJA E ZONËS ZHVILLIMORE NR.2 (GJINAR)
SH - 1 : 25 000 (KRRGJSH)
SIPËRFAQJA = 1047,74 HA



Pika	X	Y
1	516604	4541410
2	516951	4541290
3	518059	4541623
4	518556	4540975
5	520114	4541566
6	519639	4542134
7	519578	4543011
8	518674	4543116
9	518182	4543258
10	517829	4543833
11	517980	4543921
12	518037	4544550
13	517737	4544729
14	517887	4544854
15	516998	4545757
16	516434	4545902
17	515998	4545549
18	515947	4544538
19	516083	4543890
20	516287	4543458
21	516127	4543341
22	516142	4542900
23	516366	4542353
24	516688	4542126
25	516811	4542124
26	516741	4541692

GRUPI PUNËS

Asim Sula, Petrit Lamçja, Hasan Idrizi, Edlira Krraba, Englantina Doko, Gentiana Kerri, Krisi Totoshi

PLAN-VENDOSJA E ZONËS ZHVILLIMORE NR.3 (TREGAN)
SH - 1 : 15 000 (KRRGJSH)
SIPËRFAQJA = 398,1 HA



Pika	X	Y
1	504465	4544590
2	504908	4544968
3	505509	4544907
4	505925	4545469
5	506406	4545599
6	506624	4545005
7	507059	4544637
8	506838	4543921
9	507126	4543419
10	507032	4543339
11	507157	4543130
12	506597	4542789
13	506256	4543083
14	505883	4543079
15	504753	4544465

GRUPI PUNËS

Asim Sula, Petrit Lamçja, Hasan Idrizi, Edlira Krraba, Englantina Doko, Gentiana Kerri, Krisi Totoshi

PLAN-VENDOSJA E ZONËS ZHVILLIMORE NR.4 (SHUSHICË)
SH - 1 : 15 000 (KRRGJSH)
SIPËRFAQJA = 705,96 HA



Pika	X	Y
1	511298	4553527
2	514021	4554237
3	513743	4552248
4	514924	4551110
5	515092	4550440
6	514668	4549929
7	513845	4550103
8	513010	4550055
9	512575	4551371
10	512174	4551757
11	512183	4552311
12	512920	4552754
13	512979	4553257
14	512411	4553076
15	511882	4553372
16	511484	4553303

GRUPI PUNËS

Asim Sula Petrit Lamçja Hasan Idrizi Edlira Krraba Englantina Doko Gentiana Kerri Krisi Totoshi

VENDIM
Nr. 626, datë 29.10.2025

PËR SHPALLJEN E NJË ZONE ME PËRPARËSI ZHVILLIMIN E EKONOMISË MALORE NË BASHKINË SKRAPAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 20/2025, "Për paketën e maleve", me propozimin e ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen "Zonë me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore" në territorin e Bashkisë Skrapar të zonës zhvillimore nr. 1, Helmës-Staraveckë, Njësia Administrative Potom, me sipërfaqe 258 (dyqind e pesëdhjetë e tetë) ha, sipas hartës në sistemin KRRGJSH, të paraqitura mbi ortofoto.

2. Shtrirja, kufijtë dhe pikat e hyrjes e të daljes së kësaj zone përcaktohen në hartën treguese sipas sistemit KRRGJSH, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Llojet e aktiviteteve që do të zhvillohen në këtë zonë janë:

a) të zhvillimit ekonomik;

b) të zhvillimit industrial;

c) të zhvillimit turistik.

4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit, Agjencia e Zhvillimit të Territorit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Bashkia Skrapar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

PLAN-VENOSJA E ZONËS ZHVILLIMORE NR.1 (HELMËS-STARAVECKË)
SH- 1 : 10000 (KRRGJSH)
SIPËRFAQJA 258 HA



Nr.pik	E	N
1	536098.896	4482214.934
2	535791.164	4482097.134
3	535391.232	4482048.860
4	535276.767	4482225.923
5	535285.710	4482358.273
6	535240.997	4482440.545
7	535190.919	4482562.164
8	535226.689	4482626.551
9	535246.363	4482744.593
10	535458.402	4482921.580
11	535507.458	4483128.882
12	535485.303	4483437.463
13	535580.259	4483798.414
14	535990.031	4483853.525
15	536543.544	4483913.041
16	536986.938	4483840.388
17	537016.358	4483480.956
18	536931.936	4483228.970
19	536982.778	4483020.734
20	536847.966	4482950.253
21	536810.287	4482893.315
22	536754.367	4482756.647
23	536532.693	4482687.283
24	536407.018	4482616.983
25	536279.889	4482463.016

GRUPI I PUNËS

Rudina Llango Besnik Demko Devis Mustafaj Krenar Xhaferri Partizan Gorçe Altin Lamçe

VENDIM
Nr. 627, datë 29.10.2025

PËR SHPALLJEN E DISA ZONAVE ME PËRPARËSI ZHVILLIMIN E EKONOMISË MALORE NË BASHKINË BELSH

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 20/2025, "Për paketën e maleve", me propozimin e ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen "Zonë me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore" në territorin e Bashkisë Belsh të disa zonave, si më poshtë vijon:

a) Zonës nr. 1, Njësia Administrative Belsh, fshati Qafëshkallë, me sipërfaqe 126.4 (njëqind e njëzet e gjashtë pikë katër) ha, sipas hartës në sistemin KRRGJSH, të paraqitura mbi ortofoto;

b) Zonës nr. 2, Njësia Administrative Belsh, fshati Gradishtë, me sipërfaqe 1.49 (një pikë dyzet e nëntë) ha, sipas hartës në sistemin KRRGJSH, të paraqitura mbi ortofoto;

c) Zonës nr. 3, Njësia Administrative Belsh, fshati Seferan-Hysë, me sipërfaqe 68 (gjashtëdhjetë e tetë) ha, sipas hartës në sistemin KRRGJSH, të paraqitura mbi ortofoto;

ç) Zonës nr. 4, Njësia Administrative Rrasë, fshati Shegas, me sipërfaqe 69.8 (gjashtëdhjetë e nëntë pikë tetë) ha, sipas hartës në sistemin KRRGJSH, të paraqitura mbi ortofoto;

d) Zonës nr. 5, Njësia Administrative Fierzë, fshati Fierzë, me sipërfaqe 143.9 (njëqind e dyzet e tre pikë nëntë) ha, sipas hartës në sistemin KRRGJSH, të paraqitura mbi ortofoto.

2. Shtrirja, kufijtë dhe pikat e hyrjes e të daljes së këtyre zonave përcaktohen në hartën treguese sipas sistemit KRRGJSH, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Llojet e aktiviteteve që do të zhvillohen në këto zona janë:

a) të zhvillimit ekonomik;

b) të zhvillimit industrial;

c) të zhvillimit turistik.

4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit, Agjencia e Zhvillimit të Territorit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Bashkia Belsh për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku




PLANVENDOSJE E ZONES ZHVILLIMORE (GRADISHTE)
SIPERFAQA 1.49 Ha
KOORDINATAT E KUFIRIT TË ZONES (VERTETSEVE)
RAVESORE) NË SISTEMIN KRGJSH
1. X = 490723.915 Y = 4537669.177
2. X = 490744.465 Y = 4537642.060
3. X = 490974.944 Y = 4537563.440
4. X = 491004.536 Y = 4537747.257
5. X = 490959.854 Y = 4537733.547
6. X = 490849.981 Y = 4537683.152
7. X = 490806.653 Y = 4537689.920
8. X = 490785.458 Y = 4537716.571
REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA BELSH
VENDODHJA
PROJEKTI
SISTEMI KOORDINATIV
EMERTIMI I FLETES
01-04


PLANVENDOSJE E ZONES ZHVILLIMORE (SEFERAN)
SIPERFAQA 68 Ha
KOORDINATAT E KUFIRIT TË ZONES (VERTETSEVE)
RAVESORE) NË SISTEMIN KRGJSH
1. X = 489845.122 Y = 4534673.134
2. X = 489898.493 Y = 4534720.871
3. X = 489985.599 Y = 4534727.009
4. X = 490041.131 Y = 4534693.958
5. X = 490042.190 Y = 4534588.113
6. X = 490106.424 Y = 4534581.030
7. X = 490388.592 Y = 4534702.856
8. X = 490585.077 Y = 4534886.752
9. X = 490469.881 Y = 4535101.160
10. X = 490406.188 Y = 4535125.509
11. X = 490259.857 Y = 4535117.435
12. X = 490091.979 Y = 4535366.894
13. X = 489977.957 Y = 4535430.722
14. X = 489425.960 Y = 4535505.380
15. X = 489183.486 Y = 4535541.863
16. X = 489072.492 Y = 4535585.968
17. X = 489098.932 Y = 4535273.594
18. X = 489286.416 Y = 4535191.890
19. X = 489364.535 Y = 4535113.803
20. X = 489394.580 Y = 4535041.716
21. X = 489494.332 Y = 4535027.799
22. X = 489571.000 Y = 4535139.033
23. X = 489823.631 Y = 4535047.724
24. X = 489912.757 Y = 4534866.096
25. X = 489847.034 Y = 4534826.770
26. X = 489800.253 Y = 4534710.484
REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA BELSH
VENDODHJA
PROJEKTI
SISTEMI KOORDINATIV
EMERTIMI I FLETES
01-05

PLANVENDOSJE E ZONES ZHVILLIMORE (SHEGAS)
SIPERFAQA 69.8 Ha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË | BASHKIA BELSH | VENDODHJA: FSHATI SHEGAS, Bashkia Belsh | PROJEKTI: "PLANVENDOSJE E ZONËS ZHVILLIMORE" | SISTEMI KOORDINATIV: KRGJSH | EMËRTIMI I FLETËS: PLANVENDOSJE | Nr. Fleti: K-1-02

PLANVENDOSJE E ZONES ZHVILLIMORE (FIERZE)
SIPERFAQA 143.9 Ha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË | BASHKIA BELSH | VENDODHJA: FSHATI FIERZE, Bashkia Belsh | PROJEKTI: "PLANVENDOSJE E ZONËS ZHVILLIMORE" | SISTEMI KOORDINATIV: KRGJSH | EMËRTIMI I FLETËS: PLANVENDOSJE | Nr. Fleti: K-1-03

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDIM
Kërkesa nr. 34288/19

Tom NDRECA
kundër Shqipërisë

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 16 shtator 2025, si Komitet i përbërë nga:

Úna Ní Raifeartaigh, *President*,
Darian Pavli,
Mateja Đurović, *gjyqtarë*,
dhe Olga Chernishova, *zëvendëskancelar i Seksionit,*
duke pasur parasysh:

kërkesën (nr. 34288/19) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (Konventa), më 19 qershor 2019, nga shtetasi shqiptar z. Tom Ndreca (kërkuesi), i lindur në vitin 1956, me banim në Tiranë dhe i përfaqësuar nga z. A. Saccucci dhe znj. G. Borgna, avokatë që ushtrojnë profesionin e tyre në Romë;

vendimin për të njoftuar qeverinë e Shqipërisë (qeveria) të përfaqësuar nga z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit, për ankimin në lidhje me të drejtën e kërkuesit për respektimin e jetës private dhe për të shpallur të papranueshme pjesën tjetër të kërkesës;

vendimin e gushtit 2021, që rrëzon kundërshtimin e kërkuesit për pjesëmarrjen në shqyrtimin e kësaj çështjeje të z. Darian Pavli, gjyqtar i zgjedhur për Shqipërinë (ish rregulli 28 § 2 i Rregullores së Gjykatës);

parashtrimet e palëve,

pas diskutimit, vendosi si më poshtë:

OBJEKTI I ÇËSHTJES

1. Çështja ka të bëjë me shkarkimin e kërkuesit nga detyra nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) sipas ligjit për vetingun (LV) (shihni *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, nr. 15227/19, 9 shkurt 2021).

2. Kërkuesi ishte prokuror në periudhën 1991 dhe 1994, dhe gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë në periudhën 1994 dhe 2013, dhe në Gjykatën e Lartë në periudhën 2013 dhe 2018.

3. Më 17 korrik 2018, KPK-ja e shkarkoi kërkuesin nga detyra. Sipas një raporti financiar të paraqitur prej tij në lidhje me pasurinë, të ardhurat dhe likuiditetin e tij për periudhën 1980–2016, KPK-ja pranoi që ai kishte bilanc pozitiv përpara vitit 2003, por konstatoi që disa shuma të pretenduara nga kërkuesi si likuiditet (kursime) nuk ishin në deklarimet vjetore siç e kërkon ligji nr. 9049, i vitit 2003 dhe prandaj nuk ishin marrë parasysh në analizën financiare. Ai kishte bilanc negativ në 2004–08 dhe një diferencë prej 4,359 lekë në vitin 2009 (përafërsisht 50 euro në atë kohë). U vu re *mungesë e burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar pasuritë* në shumën prej 1.393.336 lekësh në 2004–09-n (përafërsisht 11,000 EUR sipas kursit të këmbimit valutor mesatar vjetor të Bankës së Shqipërisë), sipas kuptimit të nenit 33, pika 5/"b" të LV-së. Gjithashtu, KPK-ja ju referua parregullsive të tjera, përfshirë një deklarimi të rremë, në lidhje me një garazh në Tiranë dhe "kontaktit të papërshtatshëm me një person të përfshirë në krim të organizuar" sipas kuptimit të LV-së.

4. Më 22 nëntor 2018, KPA-ja la në fuqi vendimin e KPK-së për themelin dhe ia njoftoi kërkuesit më 21 dhjetor 2018. KPA-ja doli në konkluzionet e mëposhtme:

a) në vitin 2003 kërkuesi u bë pronar i një apartamenti në Tiranë (të porositur në vitin 1997 dhe të paguar pjesërisht me kursimet e familjes së tij) dhe kishte blerë veçmas garazhin e lartpërmendur për 468,000 lekë (përafërsisht 4,700 EUR sipas kërkuesit ose 3,360 euro sipas kursit të këmbimit valutor mesatar vjetor të Bankës së Shqipërisë në vitin 2003). Ai e deklaroi garazhin në deklaratën e vetingut në vitin 2017 dhe pohoi që nuk e kishte paguar atë shumë. Pretendohet që shoqëria e ndërtimit i kishte dhënë garazhin për të kompensuar defektet në apartament. Kërkuesi ju referua një planimetrie të apartamentit që tregonte defektet në strukturë dhe deklaratën e shoqërisë së ndërtimit në KPK në vitin 2018. Ai, gjithashtu, bëri deklarime të paqarta, kontradiktore ose të diskutueshme, në lidhje me apartamentin, sidomos një pretendim që pagesa prej 2.868.000 lekë përpara vitit 2003 mbulonte edhe apartamentin edhe garazhin. Megjithatë, kjo marrëveshje dhe synimet e palëve nuk ishin dokumentuar siç duhej. Kjo ngriti shqetësim për respektimin prej tij të legjislacionit që rregullon deklarimin e pasurisë dhe konfliktin e interesit. Dëshmi dokumentare të kohës –

përkatësisht një kontratë blerjeje e garazhit – vërtetonte që çmimi ishte paguar. Gjithashtu, rezultoi që një pjesë e fondeve për garazhin nuk ishin justifikuar siç duhej dhe që nuk ishte treguar – siç pretendohej për shkak të harresës – në deklarimin vjetor të kërkuesit deri në vitin 2017, edhe pse pronësia ishte regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme që në vitin 2003. Prandaj kërkuesi ka bërë "deklarim të rremë" në kuptimin e nenit 33 paragrafi 5, shkronja "ç" të LV-së, në lidhje me mos pagimin e çmimit për garazhin;

b) familja në fjalë përbëhet nga katër anëtarë, përfshirë dy fëmijët e rritur, dhe kishte mbajtur standard jetese mbi minimumin jetik, duke vënë në dukje, *inter alia*, përpjekjet për të përmirësuar standardet e jetesës përmes blerjes së pasurisë (pronë në bregdet në Golem). Edhe pse nuk mund të përcaktohej një shifër e saktë për shpenzimet thelbësore për jetesën, u përdorën të dhënat zyrtare të konsumit mujor mesatar për një familje me katër pjesëtarë;

c) raporti financiar i kërkuesit bazohej gjerësisht në deklarimet e tij, sidomos në lidhje me shumën e kursimeve të pretenduar të mbledhur përpara vitit 2003. Ato nuk ishin deklaruar në deklarimin fillestar të pasurisë, siç kërkohej. Kur vlerësohen së bashku me vlerësimin e mësipërm të shpenzimeve të jetesës, u gjet që pretendimet e tij nuk ishin të besueshme dhe u rrëzuan. KPA-ja, gjithashtu, vlerësoi të dhënat nga llogaritë bankare të familjes në fund të çdo viti, së bashku me kursimet e deklaruara në para fizike. Sipas vlerësimit financiar të KPA-së, kërkuesi nuk ishte në gjendje të justifikonte shumën 1.978.953 lekë për 2004–09. Meqë nuk i ishte dhënë mundësia për të kundërshtuar atë shifër të lartë, 1.393.336 lekë, pra e njëjta shifër e përcaktuar nga KPK-ja, u pranua si bazë për të vlerësuar justifikimin e pasurisë. Ajo ishte totali i diferencës negative të akumuluar ndërmjet vitit 2004 dhe 2009. Në mënyrë specifike, në vitin 2009 ai bleu pronë në Golem për 31,000 euro. Ai pretendoi se fondet buronin nga kursimet e pagës gjatë viteve, por nuk arriti që të justifikonte bindshëm shumën prej të paktën 1.393.336 lekë. Kjo përbënte mungesë të justifikimit të burimeve të ligjshme "për këtë pronë" dhe shkak për shkarkimin nga detyra për një deklarim të pamjaftueshëm sipas kuptimit të neneve 33, paragrafi 5, shkronja "b" dhe 61, paragrafi 3, të ligjit për LV-n përkatësisht.

Gjithashtu, KPA-ja ju referua çështjeve të tjera në vlerësimin e pasurisë dhe "kontaktit të papërshtatshëm" sipas kuptimit të LV-së sepse bashkëshortja e tij kishte blerë një makinë në vitin 2012 nga vëllai i saj, i cili ishte person në hetim.

5. Përpara Gjykatës, kërkuesi u ankua sipas nenit 8 të Konventës që shkarkimi i tij nga detyra ishte i paligjshëm dhe pretendoi, në terma të përgjithshme, që bazohej në parregullsi të vogla.

VLERËSIMI I GJYKATËS

A. Objekti i çështjes

6. Në parashtrimet e tij në vitin 2024, kërkuesi përmendi për herë të parë, pretendimet e reja, përfshirë ato për vlerësimin financiar të KPA-së në vitin 2018. Ato nuk janë shtjellim i ndonjë ankimi origjinal, përfshirë edhe të këtij ankimi bazuar në rëndesën e parregullsive të përdorura si shkak për shkarkimin e tij nga detyra dhe për të cilat palët u ftuan që të bëjnë komente. Ato nuk i janë referuar Gjykatës, në përputhje me rregullin 47 të Rregullores së Gjykatës dhe kriteret e pranueshmërisë dhe qëndrojnë jashtë objektit të çështjes si të tillë (shihni *Kulák kundër Sllovakisë*, nr. 57748/21, § 52, 3 prill 2025).

B. Neni 8 i Konventës

1. Parashtrimet e palëve

7. Qeveria shprehu përsëri gjetjet e KPA-së dhe pretendoi që ankimi ishte qartazi i pabazuar.

8. Kërkuesi pretendoi që LV-ja nuk përcaktonte "deklarimin e pamjaftueshëm", sipas nenit 61, paragrafi 3 dhe problemet serioze si të tilla që të justifikonin shkarkimin nga detyra. Organet e vetingut kishin diskrecion të gjerë dhe të pakufizuar për interpretimin e atij koncepti, gjë që çoi në zbatimin e paqëndrueshëm dhe të paparashikuar të ligjit. Mosjustifikimi nga ana e tij e një shume të vogël të kursimeve dhe apartamenti i blerë me ato kursime ishin jashtë objektit të "deklarimit të pamjaftueshëm". Zbatimi i atij koncepti – dhe urdhërimi i shkarkimit – bazuar në çështje të vogla të lidhura me deklarimin e garazhit ishte arbitrar. Garazhi ishte përfshirë në deklarimin e vetingut dhe problemi i vetëm ishte mënyra e pagesës.

9. Gjithashtu, kërkuesi pretendoi që shkarkimi i tij nga detyra nuk bëhej për qëllim legjitim, bazohej në parregullsi të vogla dhe nuk ishte proporcional. Asgjë nuk tregonte që ai kishte vepruar në keqbesim ose kishte shkelur ligjin me dashje. Fakti që shkelja nuk ishte bërë me dashje duhej të peshonte mjaftueshëm në favorin e tij. KPA-ja la në fuqi gjetjet e KPK-së që diferenca në 2009-n ishte 50 euro dhe më tej vendosi që atij i mungonte shuma

1.393.336 lekë e fondeve për të blerë apartamentin në të njëjtin vit (shihni paragrafin 3 më lart). Kjo gjetje bazohej në një vlerësim financiar që nuk i ishte treguar atij, rëndonte pozitën e tij dhe pengonte edhe të kuptuarin e plotë nga ana e tij të çështjes kundër tij dhe aftësinë e tij për t'u përgjigjur si duhej. Shuma përbënte vetëm 1/30 e të ardhurave të tij të ligjshme për periudhën 1980–2016. Për krahasim, sipas ligjit 9049/2003, në rastin e deklarimeve vjetore, pasuritë konsiderohen të blera në mënyrë të paligjshme dhe denoncohen për ndjekje penale vetëm kur mospërputhja e pajustifikuar kalon shumën 2,000,000 lekë. KPA-ja, në mënyrë arbitrare, doli në përfundimin që çmimi i blerjes së garazhit ishte paguar. Pasuria me vlerë të ulët ishte deklaruar në deklaratën për vetingun. Nuk ishte konkluduar që fondi i përdorur për blerjen e saj kishte qenë i paligjshëm.

2. Vlerësimi i Gjykatës

10. Shkarkimi i kërkuesit nga detyra ndërhynte në të drejtën e tij për respektimin e jetës private dhe do të ishte shkelje e nenit 8 të Konventës nëse nuk justifikohet si i tillë që është në përputhje me ligjin dhe i nevojshëm në një shoqëri demokratike për të ndjekur një qëllim legjitim (shihni *Thanza kundër Shqipërisë*, nr. 41047/19, §§ 135 dhe 137, 4 korrik 2023).

11. Në lidhje me vlerësimin e pasurive (përfshirë banesën në Golem dhe garazhin në Tiranë), pretendimet e kërkuesit që kundërshtojnë ligjshmërinë e ndërhyrjes dhe mungesën e një qëllimi legjitim, sa kohë që nuk janë shpallur të papranueshme në fazën e komunikimit, janë të ngjashme me ato të refuzuara nga Gjykata në një kontekst të ngjashëm (shihni *Thanza*, cituar më lart, §§ 141–47, me referenca të mëtejshme). Gjykata nuk gjen arsye për t'u shprehur ndryshe. Mbetet për t'u vendosur nëse ndërhyrja ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike dhe proporcionale për të arritur qëllimet legjitime.

12. Së pari, në formularin e tij të kërkesës kërkuesi kundërshtoi disa të meta procedurale të pretenduara, në lidhje me gjetjet e faktit dhe konkluzionet ligjore, në lidhje me banesën në Golem dhe garazhin, duke ju referuar nenit 6 të Konventës. Këto ankime u shpallën të papranueshme si dukshëm të pabazuara në momentin e komunikimit të kësaj kërkese. Në parashtrimet e tij në vitin 2024, kërkuesi shprehu të njëjtat pretendime si një aspekt i veçantë sipas nenit 8. Gjykata nuk ka identifikuar mangësi të rënda në procesin e vendimmarrjes me anë të të cilit konstatimet e mësipërme u nxorën në nivel kombëtar dhe nuk sheh arsye për të dalë në një konkluzion të ndryshëm për pranueshmërinë e atyre pretendimeve sipas nenit 8 (krahasoni *Thanza*, cituar më sipër, § 158).

13. Së dyti, kërkuesi ka kundërshtuar si arbitrar interpretimin nga KPA-ja të legjislacionit të brendshëm për banesën në Golem dhe garazhin në Tiranë. Siç prezantohet dhe provohet, këto pretendime nuk kalojnë kufirin e arbitraritetit apo mungesës së dukshme të arsyeshmërisë (shihni *Yüksel Yalçınkaya kundër Turqisë* [DHM], nr. 15669/20, § 304 *in fine*, 26 shtator 2023).

14. Kështu, Gjykata do të shqyrtojë vetëm pretendimin fillestar të mungesës së proporcionalitetit bazuar në faktet që u përcaktuan dhe vlerësuan nga KPA-ja dhe bazuar në parashtrimet e kërkuesit, duke shtjelluar natyrën e parëndësishme të parregullsive në kuadër të vlerësimit të pasurive.

15. Kërkuesi deklaroi që kishte përdorur kursimet e mbledhura nga pagat e familjarëve në 2004–09 për të blerë pronën në Golem për 31,000 euro në vitin 2009. KPA-ja u shpreh që ai nuk arriti të justifikonte një masë të konsiderueshme të fondeve të përdorura për atë blerje, përafërsisht 11,000 euro dhe që kjo përfshihej në objektin e arsyes për shkarkim nga detyra sipas nenit 61 (3) të LV-së. Sipas Gjykatës, kjo shumë jo vetëm që ishte e konsiderueshme në kontekstin e transaksionit, por edhe nuk ishte e vogël, nisur nga niveli i pagave për nëpunësit shqiptarë në atë kohë. Gjithashtu, kërkuesi nuk ka treguar që diferenca negative e familjes së tij ndërmjet 2004 dhe 2009 përbënte një përqindje të vogël të të ardhurave të kombinuara të familjes për atë periudhë, duke pasur parasysh pagat e anëtarëve të familjes së tij, sepse bashkëshortja dhe fëmijët e rritur të tij, gjithashtu, ishin punësuar në sektorin publik (krahasoni *Sevdari kundër Shqipërisë*, nr. 40662/19, § 93, 13 dhjetor 2022). Gjithashtu, është vërejtur që të paktën një pjesë e kursimeve të pretenduara të akumuluara përpara vitit 2004 ishte shpenzuar për blerjen e një prone tjetër, dhe ajo shumë – ose pjesa e mbetur – nuk ishte deklaruar për vitin 2003 ose më pas.

16. KPA-ja, gjithashtu, refuzoi si të rremë pretendimet e kërkuesit që ai nuk kishte paguar për garazhin e blerë në vitin 2003, pra kur ai u bë subjekt

i kërkesave të ligjit nr. 9049. Një deklarim i rremë i bërë në kuadër të detyrimit të subjektit të vetingut për të deklaruar me vërtetësi edhe pasurinë edhe burimin e saj, konsiderohej një lloj i veçantë i parregullsisë në procesin e vetingut (shihni *Thanza*, cituar më lart, §§ 68–71) dhe mund të prekë gjurmueshmërinë dhe integritetin e transaksioneve. Deklarimi i kërkuesit u vlerësua duke pasur parasysh kombinimin e faktorëve. Pa ndonjë shpjegim të vlefshëm, garazhi i regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme që në vitin 2003 nuk ishte reflektuar në deklaratat e tij vjetore deri në procesin e vetingut në vitin 2017. KPA-ja gjeti që ai dha shpjegime që nuk përputheshin dhe që nuk ishin bindëse në lidhje me financimin e apartamentit dhe garazhit. Ai mohoi pagesën pavarësisht dokumentacionit që provonte të kundërtën. Ky informacion i rremë cenonte besueshmërinë e deklarimit. Pra, edhe pse deklarimi i rremë kishte të bënte me një vlerë monetare që mund të mos konsiderohet e madhe, kjo nuk ul rëndesën e konkluzioneve të KPA-së, në lidhje me mangësitë për këtë pasuri (krahasoni *Sevdari*, cituar më lart, § 85).

17. Nëse gjykatat e brendshme kanë shqyrtuar me kujdes faktet, kanë zbatuar standardet e të drejtave të njeriut në vazhdimësi me Konventë dhe praktikën gjyqësore, dhe kanë balancuar sa duhet interesin personal me interesin publik në një çështje, Gjykata do të kërkonte arsye të forta për të zëvendësuar këndvështrimin e saj me atë të gjykatave të brendshme (shihni *Halet kundër Luksemburgut* [DHM], nr. 21884/18, § 161, 14 shkurt 2023). Duke theksuar gjetjet në paragrafët 6 dhe 12–14 më sipër, natyrën e parregullsive të mësipërme dhe qëndrimin e kërkuesit si një gjyqtar me përvojë nga i cili pritej që të përmbushte standardet e integritetit dhe moralit në zhvillimin e çështjeve private financiare (shihni *Xhoxhaj*, cituar më lart, § 407 *in fine*), arsyet e dhëna prej tij nuk janë të mjaftueshme që Gjykata të devijojë nga konkluzionet e KPA-së dhe në përgjithësi të rrëzojë rezultatin e çështjes së vetingut (shihni për krahasim *Sevdari*, cituar më lart, §§ 93 dhe 96). Pretendimet e mbetura të kërkuesit, më tipike, janë të ngjashme me ato të refuzuara në çështjen *Nikëhasani kundër Shqipërisë*, nr. 58997/18, §§ 126 dhe 128–29, 13 dhjetor 2022. Prandaj, Gjykata nuk gjen që shkarkimi i tij nga detyra nuk ka qenë disproporcional.

18. Nisur nga kjo gjetje, nuk është e nevojshme që Gjykata të analizojë gjetjet dhe konkluzionet e KPA-së, në lidhje me elemente të tjera të vlerësimit të pasurisë ose kontaktit të pretenduar të papërshtatshëm (krahasoni *Thanza*, cituar më lart §160).

19. Në këto rrethana, ankimi sipas nenit 8 është haptazi i pabazuar dhe duhet të refuzohet në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata, unanimisht,

Shpall kërkesën të papranueshme.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 9 tetor 2025.

PRESIDENT
Úna Ní Raifeartaigh

ZËVENDËS KANCELAR NË DETYRË
Olga Chernishova

VENDIM
Nr. 43, datë 24.7.2025

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare,
Marsida Xhaferllari	anëtare,
Fiona Papajorgji	anëtare,
Sonila Bejtja	anëtare,
Ilir Toska	anëtar,
Genti Ibrahimi	anëtar,
Marjana Semini	anëtare,
Sandër Beci	anëtar,

me sekretare Blerina Basha, në datat 12.6.2025 dhe 26.6.2025, mori në shqyrtim në seancë plenare çështjen nr. 16 (S) 2024 të Regjistrit Themeltar që u përket:

KËRKUESE: SINDIKATA E BASHKUAR E ARSIMIT SHQIPTAR, përfaqësuar nga presidente Alma Lama dhe avokate Margarita Kola, me prokurë të posaçme.

SUBJEKTI I INTERESUAR:

KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar nga Herald Jonuzaj, Vangjel Duni, Irma Qosja, avokate shteti, Enkela Dudushi dhe Voltisa Koçi, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi pjesërisht i vendimit nr. 425, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar", pikërisht pika 2.ii, vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit për grupin vetëm nivelet 6 dhe 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve *(KSHK),* master profesional, dhe niveli 6 dhe të lidhjes nr. 4, si pjesë përbërëse e vendimit për pjesën e vlerës së shtesës së nivelit të kualifikimit për grupin e diplomës 2, KSHK 7 dhe grupi i diplomës 3, KSHK 6, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 17, 18, 49, 50, 131, pika 1, shkronja "c" dhe 134, pika 1, shkronja "h", si dhe 135 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta);* ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim pretendimet e kërkueses Sindikatës së Bashkuar të Arsimit Shqiptar *(kërkuesja)*, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kuvendi më datë 21.6.2012 ka miratuar ligjin nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" *(ligji nr. 69/2012),* i cili ka hyrë në fuqi më datë 9.8.2012. Objekti dhe qëllimi i këtij ligji janë përcaktimi i parimeve bazë për strukturën, veprimtarinë dhe qeverisjen e sistemit arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, si dhe garantimi i së drejtës kushtetuese për arsim, sipas kuadrit ligjor përkatës për funksionimin e sistemit arsimor parauniversitar. Ligji ka pësuar disa ndryshime me ligjet nr. 56/2015, datë 28.5.2015, nr. 48/2018, datë 23.7.2018 *(ligji nr. 48/2018)* dhe nr. 44/2023, datë 15.6.2023.

2. Në zbatim të ligjit nr. 69/2012 u miratua vendimi nr. 175, datë 8.3.2017, i Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar" *(VKM-ja nr. 175/2017).* Në pikën 3 të tij përcaktohej struktura e pagës mujore, që përbëhej nga paga e grupit (niveli arsimor, që varionte nga 10 000 lekë deri në 14 000 lekë), shtesa për vjetërsi pune, shtesa e kualifikimit dhe shtesa e pozicionit.

3. VKM-ja nr. 175/2017 u ndryshua me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 351, datë 19.4.2017, 'Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 175, datë 8.3.2017, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar"' *(VKM-ja nr. 351/2017).* Sipas këtij vendimi, punonjësit aktualë mësimorë/edukatorë, të cilët zotërojnë diplomë të ciklit të parë të studimeve universitare "Bachelor" ose të barasvlershme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë dhe deri përpara datës 1 mars 2017 kanë përfituar pagën e grupit në masën 14 000 (katërmbëdhjetë mijë) lekë, do të vazhdojnë të përfitojnë të njëjtën masë të pagës së grupit deri në momentin e ndryshimit të nivelit të diplomës, ose ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me institucionin arsimor përkatës. Punonjësit mësimorë/edukatorë që fillojnë punë për herë të parë si punonjës mësimorë/edukatorë në arsimin parauniversitar pas datës 1 mars 2017, do të trajtohen me pagë grupi sipas përcaktimeve të lidhjes nr. 2 të vendimit, ku përcaktohen pagat për nivelin arsimor (diploma master-vlera 14 000 lekë; diploma bachelor-vlera 11 000 lekë dhe diploma e shkollës së mesme pedagogjike-vlera 10 000 lekë).

4. Me ligjin nr. 48/2018, mes të tjerave, u ndryshua edhe neni 57 i ligjit nr. 69/2012, duke parashikuar se mësuesi për arsimin parashkollor duhet të ketë fituar diplomën e ciklit të parë "Bachelor", që formon mësues të arsimit parashkollor. Mësuesi për arsimin fillor duhet të ketë fituar diplomën e ciklit të parë "Bachelor" dhe diplomën e ciklit të dytë "Master profesional", që formojnë mësues të arsimit fillor, ose diplomë për arsimin fillor të ish-instituteve të larta pedagogjike. Mësuesi për arsimin e mesëm të ulët (nga klasa e VI-IX) dhe për arsimin e mesëm të lartë (gjimnazi, arsimi i mesëm profesional dhe arsimi mesëm

orientues) duhet të ketë fituar diplomën e ciklit të parë "Bachelor" në fushën/lëndët e arsimit të mesëm të ulët dhe të arsimit të mesëm të lartë dhe diplomën e ciklit të dytë "Master" me 120 ECTS në fushën e mësuesisë, që lidhet me programin e studimit të ciklit të parë.

5. Po me ligjin nr. 48/2018, në nenin 72 të ligjit nr. 69/2012 u shtua pika 6 me këtë parashikim: "Personelit mësimdhënës, që ka përfunduar studimet universitare në ish-institutet e larta pedagogjike, diploma e përfituar i njihet si arsim i lartë, tetë semestra, për efekt page.". Në referim të nenit 124 të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" *(ligji nr. 80/2015),* diplomat e programeve të studimit, të lëshuara në Republikën e Shqipërisë, që kanë zgjatur, së paku, 4 vjet akademikë (8 semestra), deri në përshtatjen e studimeve, sipas parimeve të procesit të Bolonjës, janë ekuivalente me diplomat "Master i shkencave".

6. Këshilli i Ministrave, në zbatim të ligjit nr. 69/2012 dhe të ligjit nr. 35/2023, "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", më datë 26.6.2024 ka miratuar vendimin nr. 425, datë 26.6.2024, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar" *(VKM-ja nr. 425/2024).* Ky vendim ka hyrë në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare nr. 112, datë 3.7.2024, duke shfuqizuar VKM-në nr. 175/2017 dhe i ka shtrirë efektet financiare nga data 1.7.2024.

7. Fusha e veprimit të VKM-së nr. 425/2024 shtrihet ndaj punonjësve mësimorë (mësues/edukatorë, instruktorë), punonjësve të shërbimit psikosocial, si dhe punonjësve të tjerë jomësimorë, që shërbejnë në institucionet arsimore të sistemit arsimor parauniversitar (arsimin parashkollor, arsimin fillor, arsimin e mesëm të ulët, arsimin e mesëm të lartë, institucionet arsimore për përkujdesjen për kategori të veçanta të nxënësve, qendrat kulturore të fëmijëve dhe konviktet e nxënësve).

8. Në pikën 2 të VKM-së nr. 425/2024 parashikohen pesë elementet përbërëse të pagës bruto mujore të punonjësve të sipërcituar, që përbëhet nga: i. paga për pozicion, që shpërblen vlerën relative të çdo pozicioni pune; ii. shtesa e nivelit të kualifikimit, që shpërblen nivelin arsimor të kërkuar për pozicionin përkatës të punës. Kjo vlerë përcaktohet në lidhjen nr. 4 bashkëlidhur vendimit dhe është pjesë përbërëse e tij; iii. shtesa për vjetërsi pune; iv. shtesa për kategoritë e kualifikimit, që shpërblen zhvillimin profesional të punonjësve mësimorë përgjatë karrierës së tyre, pas përfitimit të kategorisë së kualifikimit do të llogaritet në përqindje për çdo kategori, duke filluar nga 10% (mësues i kualifikuar), 20% (mësues special) dhe 30% (mësues mjeshtër); v. shtesa për natyrë të veçantë pune, e aplikueshme për disa pozicione në shkollat e arsimit të mesëm të lartë profesional.

9. Kërkuesja, me kërkesën e datës 1.11.2024, e cila është regjistruar më datë 12.11.2024, pas plotësimit të dokumenteve sipas nenit 27 të ligjit nr. 8577/2000, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)* për shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të pikës 2.ii të VKM-së, që parashikon se një ndër elementet përbërëse të pagës bruto mujore të punonjësve mësimorë, që shërbejnë në institucionet e arsimit të sistemit arsimor parauniversitar, është edhe shtesa e nivelit të kualifikimit, që shpërblen nivelin arsimor të kërkuar për pozicionin përkatës të punës, si dhe të lidhjes nr. 4, si pjesë përbërëse të VKM-së, ku janë të përcaktuara vlerat e shtesës së nivelit të kualifikimit për çdo grup diplome. Kolegji i Gjykatës më datë 24.1.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Në seancën plenare mbi bazë të dokumenteve të datës 12.6.2025, për nevoja të përcaktimit të fakteve, Gjykata ka vendosur ndryshimin e formës së shqyrtimit të çështjes nga seancë plenare mbi bazë të dokumenteve në seancë plenare publike më datë 26.6.2025.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

10. ***Kërkuesja,*** në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar:

10.1 *Për juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese*

10.1.1 Gjykata ka juridiksion për shqyrtimin e VKM-së nr. 425/2024, pasi është një akt me karakter normativ, vendos norma të përgjithshme, që shtrijnë efektet e tyre mbi një kategori të pacaktuar subjektesh, që janë mësues dhe punonjës

të arsimit të të gjitha niveleve të arsimit parauniversitar dhe ka karakter detyrues.

10.2 *Për themelin, VKM-ja nr. 425/2024 cenon*:

10.2.1 *Parimin e sigurisë juridike,* pasi punonjësit e arsimit që kishin përfituar pagën e grupit në masën 14 000 lekë duhet të vazhdonin të trajtoheshin nga VKM-ja nr. 425/2024 po me këtë masë page. Por ndryshimet që solli VKM-ja nr. 425/2024 bënë që kjo vlerë të mos përfitohej më, duke cenuar një të drejtë të fituar. Çdo ndryshim duhet të jetë në përputhje me ligjin dhe të jetë në interes të të dyja palëve. Punonjësit kanë të drejtë të mbrohen nga ndryshimet që mund të ndikojnë negativisht në kushtet e tyre të punës, në pagë ose në të drejtat e tjera të fituara. Nëse një punonjës dëshiron të bëjë ndryshime në kontratën e punës, është e rëndësishme që këto ndryshime të diskutohen dhe të miratohen nga ai. Në rast mosmarrëveshjeje, punonjësit kanë të drejtë të ndjekin rrugën ligjore për të mbrojtur të drejtat e tyre. Me nenin 20 të ligjit nr. 48/2018, në nenin 72 të ligjit nr. 69/2012 u shtua pika 6, sipas së cilës personeli mësimdhënës, që ka përfunduar studimet universitare në ish-institutet e larta pedagogjike, diploma e përfituar i njihet si arsim i lartë, tetë semestra, për efekt page. Pra, personeli që ka diplomë "Bachelor", sipas asaj periudhe (pasi nuk kishte diploma "Master"), paguhej në vlerën 14 000 lekë, që i korrespondon diplomës "Master". Ndërsa me VKM-në nr. 425/2024 këta punonjës nuk vazhdojnë të paguhen me këtë shumë, pasi për nivelin e kualifikimit "Bachelor" parashikohet vlera në shumën 10 000 lekë. Për më tepër, gjatë zbatimit praktik të vendimit objekt kundërshtimi ka pasur paqartësi, pasi disa zyra vendore arsimore zbatojnë vlera të ndryshme pagese për të njëjtën kategori të kornizës së kualifikimit. Gjithashtu, një ndër kërkesat e parimit të sigurisë juridike është bërja sa më publike e akteve normative. Kjo do të thotë jo vetëm botimi në Fletoren Zyrtare, por edhe transparenca, diskutimi publik dhe pjesëmarrja e gjerë e ekspertëve të fushës, grupeve të interesit ose individëve të veçantë edhe në procesin e miratimit të tyre nga mekanizmat përkatës. Shuma e pagës e përfituar gjatë detyrës së mësuesit do të ndikojë edhe në masën e pensionit në të ardhmen.

10.3 *Parimin e hierarkisë së normave juridike, të garantuar në nenin 116 të Kushtetutës,* pasi VKM-ja nr. 425/2024 është në kundërshtim me ligjin nr. 48/2018, konkretisht me pikën 6 të nenit 72 të tij, pra ky vendim nuk është i bazuar në ligj.

10.4. *Parimin e barazisë përpara ligjit dhe të mosdiskriminimit,* pasi përpara miratimit të VKM-së nr. 425/2024 punonjësit mësimorë trajtoheshin në mënyrë të barabartë sipas ligjit nr. 69/2012. Pas miratimit të vendimit dhe sipas përcaktimeve të lidhjes nr. 4 të tij, kategoria e punonjësve të arsimit me diplomën "Bachelor" (niveli 6 i KSHK) do të marrë vlerën 10 000 lekë, ajo me diplomë "Master profesional" ose të barasvlershme (niveli 7 i KSHK-së) do të marrë vlerë 12 000 lekë dhe "Master shkencor" do të marrë vlerën 14 000 lekë, në një kohë kur të dyja kategoritë trajtoheshin me vlerën e shtuar 14 000 lekë.

11. ***Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave***, ka prapësuar si vijon:

11.1 *Për juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese*

11.1.1 Gjykata nuk ka juridiksion për shqyrtimin e VKM-së nr. 425/2024, pasi ajo kontrollon kushtetutshmërinë e akteve e jo ligjshmërinë e tyre dhe pretendimet e kërkueses janë me natyrë ligjore. VKM-ja, si akt nënligjor, nuk i është nënshtruar gjykimit në Gjykatën Administrative të Apelit dhe kjo e fundit të ketë rezultuar një mjet ankimi joefektiv. Gjithashtu, VKM-ja nr. 175/2017, e ndryshuar me VKM-në nr. 351/2017, është shfuqizuar nga vendimi objekt kundërshtimi. Norma e re ka një përmbajtje thellësisht të ndryshme nga norma e tjetër dhe pretendimet e kërkueses kanë të bëjnë me një normë që nuk është në fuqi, pra nuk prodhon efekte juridike.

11.2 *Për themelin për VKM-në nr. 425/2024:*

11.2.1 *Pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike nuk gjen mbështetje në parashikimet kushtetuese dhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ)*, pasi paga mujore për mësuesit e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët në shkollat 9-vjeçare ka pësuar rritje, duke sjellë efekte financiare pozitive për çdo mësues. Në interpretimin literal të dispozitave të ligjit nr. 69/2012, si dhe ligjit nr. 80/2015, diploma e nivelit "Bachelor" që i korrespondon nivelit 6 të kornizës shqiptare të kualifikimeve nuk është e barasvlershme me diplomat që i përkasin nivelit 7 të kornizës shqiptare të kualifikimeve "Master". Këshilli i Ministrave, nëpërmjet këtij akti, ka konkretizuar elementet përbërëse të pagës mujore bruto të punonjësve të institucioneve të sistemit arsimor parauniversitar. Ndryshimet në shtesat mbi pagë nuk janë të drejta të patjetërsueshme, por përfitime të përcaktuara në akte administrative, që mund të rishikohen sipas

politikave sociale të qeverisë. Trajtimi i mëparshëm duke iu dhënë disa grupeve më të ulëta diplomën shtesë kualifikimi të njëjtë me atë të grupeve më të larta të diplomës, përbënte "diskriminim pozitiv", por nuk mund të konsiderohet e drejtë e fituar e pandryshueshme, pasi nuk mbështetet në arsye ose rrethana objektive. Për këtë qëllim, VKM-ja nr. 425/2024 e ka rikthyer situatën duke trajtuar financiarisht grupet e diplomave sipas niveleve të tyre, për rrjedhojë nuk cenon parimin e sigurisë juridike. Gjithashtu, VKM-ja nr. 425/2024 përjashtohet nga detyrimi i nënshtrimit të procesit të konsultimit publik, pasi bën pjesë në ato akte që nuk i nënshtrohen atij procesi bazuar në ligjin nr. 146/2014, "Për njoftimin dhe konsultimin publik".

11.2.2 *Për pretendimin për cenimin e parimit të hierarkisë së normave juridike* kërkuesja nuk ka parashtruar argumente në nivel kushtetues. VKM-ja ka dalë në zbatim të ligjeve nr. 69/2012 dhe nr. 35/2023 dhe nuk trajton çështje në kundërshtim me rezervën ligjore. Ligji nr. 35/2023 ka parashikuar në mënyrë të përgjithshme kuadrin rregullator për caktimin e pagave, trajtimet e tjera financiare dhe përfitimet e të punësuarve në institucionet e administratës publike dhe ka autorizuar Këshillin e Ministrave për miratimin e elementeve përbërëse të pagës bruto mujore dhe të vlerës për çdo element të saj.

11.2.3 *Pretendimi për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit dhe të mosdiskriminimit* është i pabazuar. Në çdo rast, edhe nëse ka ndërhyrje, ajo ka ndjekur një qëllim legjitim dhe proporcional me gjendjen e diktuar. Niveli i kualifikimit arsimor, i diferencuar sipas ligjit nr. 10247, datë 4.3.2010, "Për kornizën shqiptare të kualifikimeve" *(ligji nr. 10247/2010)* do të sillte edhe diferencim në trajtimin financiar të punonjësve arsimorë, me qëllim garantimin e një shpërblimi të drejtë dhe dinjitoz për çdo punonjës mësimor dhe punonjësve të tjerë jomësimorë në institucionet arsimore, si dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar, në përputhje me nivelin e kualifikimit të tyre. Elementet për realizimin e reformës së pagave të nëpunësve/punonjësve të administratës publike dhe rritjen e niveleve të tyre janë "shtesa për vjetërsi në punë" dhe "shtesa për nivelin e kualifikimit", që i referohen kornizës shqiptare të kualifikimit. Pra, janë harmonizuar dhe janë marrë në konsideratë të gjitha vlerat që mbartin nëpunësit e administratës publike, ku bëjnë pjesë edhe punonjësit mësimorë.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkueses

12. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Në gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, subjektet, që parashikohen në nenin 134, pika 2, të Kushtetutës, kanë detyrimin për të provuar interesin ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur (*shih vendimet nr. 4, datë 15.2.2021; nr. 1, datë 16.1.2017; nr. 14, datë 21.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese).*

13. Për legjitimimin e organizatave, si subjekte që vënë në lëvizje Gjykatën, sipas nenit 134, pika 1, shkronja "h", të Kushtetutës, Gjykata ka tashmë një jurisprudencë të konsoliduar, sipas së cilës vlerësimi nëse një organizatë ka ose jo mjaftueshëm interes, bëhet rast pas rasti, në varësi të rrethanave të çdo çështjeje të veçantë. Organizata që vë në lëvizje Gjykatën duhet të provojë se në çfarë mënyre ajo mund të preket në një aspekt të veprimtarisë së saj, pra duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që ekziston midis veprimtarisë së saj dhe normës që kundërshton *(shih vendimet nr. 20, datë 20.4.2021; nr. 1, datë 16.1.2017; nr. 33, datë 8.6.2016 të Gjykatës Kushtetuese).* Gjithashtu, Gjykata ka vlerësuar se nuk është e nevojshme të provohet që subjektet me legjitimitet të kushtëzuar përfaqësojnë të gjithë profesionistët e asaj fushe, pasi, në kuptim të nenit 134 të Kushtetutës, një kërkesë e tillë nuk përbën kusht për legjitimimin e tyre *(shih vendimet nr. 11, datë 6.3.2014; nr. 11, datë 6.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në rastin konkret, në lidhje me aspektin formal të legjitimimit të kërkueses në gjykimin kushtetues, vërehet se ajo është regjistruar si person juridik me vendimin nr. 3, datë 15.2.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe bazuar në statutin e sindikatës, ajo është bashkim vullnetar sindikal, që përfaqëson punëmarrësit në arsimin parashkollor, parauniversitar, të lartë, profesional dhe punëmarrësit e tjerë në këto sektorë të punësuar në Republikën e Shqipërisë. Kërkesa e paraqitur më datë 1.11.2024 është nënshkruar nga Alma Lama, presidente e sindikatës, e cila, sipas nenit 21 të statutit, mes të tjerave, ka në kompetencën e saj përfaqësimin e interesave të punëmarrësve përpara institucioneve shtetërore. Për rrjedhojë, Gjykata

vlerëson se kërkuesja legjitimohet *ratione personae* për të paraqitur kërkesë, pasi ka justifikuar interesin e saj. Gjithashtu, për legjitimimin *ratione temporis,* VKM-ja nr. 425/2024 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 112, datë 3.7.2024, ka hyrë në fuqi pas botimit në këtë fletore dhe i ka shtrirë efektet financiare nga data 1.7.2024. Kërkesa është paraqitur në Gjykatë më datë 1.11.2024, pra brenda afatit ligjor 2-vjeçar të parashikuar në nenin 50, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ndaj kërkuesja legjitimohet edhe *ratione temporis* për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

15. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, Gjykata konstaton se kërkuesja ka parashtruar pretendime për cenimin e parimeve të: i) hierarkisë së normave juridike; ii) sigurisë juridike në drejtim të të drejtave të fituara; iii) barazisë përpara ligjit dhe të mosdiskriminimit.

16. Për pretendimin për cenimin e parimit të hierarkisë së normave juridike, Gjykata vëren se kërkuesja ka parashtruar se VKM-ja nr. 425/2024 është në kundërshtim me ligjin nr. 48/2018, konkretisht me pikën 6 të nenit 72 të tij, pra ky vendim nuk është i bazuar në ligj, duke mos respektuar parimin e hierarkisë së normave juridike. Ndërsa subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar se kërkuesja nuk ka parashtruar argumente në nivel kushtetues. VKM-ja ka dalë në zbatim të ligjeve nr. 69/2012 dhe nr. 35/2023 dhe nuk trajton çështje në kundërshtim me rezervën ligjore.

17. Gjykata ka theksuar se respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin *ligjor (shih vendimin nr. 20, datë 20.4.2021 të Gjykatës Kushtetuese).* Piramida e akteve normative, e sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, përcakton marrëdhëniet midis normave juridike, të cilat bazohen në raportin e mbi/nënvendosjes së tyre. Rendi juridik nuk është një radhitje e barasvlershme normash, por një sistem hierarkik, i cili përbëhet nga nivele të ndryshme vlefshmërie dhe në secilin prej këtyre niveleve qëndron një normë ose grup normash, duke përftuar kështu edhe fuqinë e caktuar juridike. Kjo piramidë aktesh normative ka në majë të saj Kushtetutën, e cila shërben si burim për aktet e tjera juridike (*shih vendimet nr. 5, datë 5.2.2014; nr. 3, datë 20.2.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në vijim të sa më lart, Gjykata vlerësoi se pretendimi për cenimin e parimit të hierarkisë së normave juridike përbën lëndë kushtetuese në kuptim të kompetencës së Gjykatës për t'i vlerësuar ato, megjithatë është natyra e argumenteve të ngritura nga kërkuesja që përcakton nëse është Gjykata në rastin konkret kompetente për vlerësimin e kushtetutshmërisë së sjelljeve/veprimeve që, sipas kërkueses, përbëjnë cenim të këtij parimi. Në këtë drejtim nuk u arrit numri i nevojshëm i votave për vendimmarrje sipas nenit 73, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000 lidhur me natyrën e argumenteve të parashtruara nga kërkuesja dhe pretendimi u konsiderua i rrëzuar.

19. Sipas njërit qëndrim, u vlerësua se pretendimi i kërkueses në këtë drejtim është me natyrë ligjore, pasi ka të bëjë me përplasjen mes aktit nënligjor dhe ligjit, për rrjedhojë nuk ka natyrë kushtetuese[2]. Kështu, për shembull, pretendimet që lidhen me cenimin e rezervës kushtetuese (kur Kuvendi miraton një ligj që praktikisht ndryshon një dispozitë kushtetuese ose konventore) ose ligjore (kur aktet nënligjore dalin jashtë kufijve të rregullimeve dhe autorizimeve ligjore), tipikisht aktivizojnë juridiksionin e Gjykatës për të vlerësuar kushtetutshmërinë e akteve të kontestuara nën prizmin e hierarkisë së normave juridike të parashikuar nga neni 116 i Kushtetutës. Nga ana tjetër, pretendimet për shkelje materiale të përmbajtjes/urdhërimit të një akti ligjor nga përmbajtja/urdhërimi i një akti nënligjor tipikisht, aktivizojnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme administrative.

20. Ndërsa sipas qëndrimit tjetër, kërkuesja e ka mbështetur pretendimin për cenimin e parimit të hierarkisë së normave juridike në argumentin se akti është në kundërshtim me pikën 6 të nenit 72 të ligjit nr. 48/2018, për rrjedhojë nuk është i bazuar në ligj, duke mos respektuar hierarkinë e normave juridike. Ky pretendim në thelb lidhet me rregullat që Këshilli i Ministrave zbaton në miratimin e akteve nënligjore, në kuptim të neneve 116 dhe 118 të Kushtetutës. Në lidhje me këtë, në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se është e vërtetë se organet kushtetuese, me kompetenca në nxjerrjen e akteve normative ose

[2] Gjyqtarët Holta Zaçaj, Ilir Toska, Genti Ibrahimi dhe Marjana Semini vlerësuan sipas këtij qëndrimi.

individuale, kanë hapësirën e tyre të vlerësimit për rregullimin e çështjeve në kompetencë të tyre, por në zgjedhjen e instrumentit ligjor ato duhet të respektojnë shtetin e së drejtës, të garantojnë koherencën e rendit juridik dhe hierarkinë e normave të tij *(shih vendimin nr. 29, datë 2.7.2021 të Gjykatës Kushtetuese)*. Për rrjedhojë, pretendimi ka natyrë kushtetuese dhe përfshihet në juridiksionin kushtetues[3].

21. Gjykata vlerëson se pretendimet/argumentet për cenimin e parimeve të sigurisë juridike në drejtim të të drejtave të fituara dhe barazisë përpara ligjit e mosdiskriminimit janë me natyrë kushtetuese dhe në vijim do t'i shqyrtojë së bashku, duke mbajtur në konsideratë se në thelb parashtrohen të njëjtat argumente.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e parimeve të sigurisë juridike dhe të barazisë përpara ligjit e të mosdiskriminimit

22. Kërkuesja, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se VKM-ja nr. 425/2024 ka përkeqësuar gjendjen e punonjësve të arsimit, pasi ka ndryshuar vlerën e shtesës së nivelit të kualifikimit për çdo grup diplome, si një ndër elementet përbërëse të pagës bruto mujore të punonjësve, duke parashikuar vlerë më të ulët se ajo që përfitonin më parë. Në këtë drejtim, subjekti i interesuar ka prapësuar se në çdo rast, edhe nëse ka pasur ndërhyrje, ajo ka ndjekur një qëllim legjitim dhe proporcional me gjendjen e diktuar. Niveli i kualifikimit arsimor i diferencuar sipas ligjit nr. 10247/2010 do të sillte edhe diferencim në trajtimin financiar të punonjësve arsimorë, me qëllim garantimin e një shpërblimi të drejtë dhe dinjitoz për çdo punonjës mësimor dhe punonjësve të tjerë jomësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar, në përputhje me nivelin e kualifikimit të tyre.

23. Subjekti i interesuar, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se pretendimet e kërkueses lidhen me parashikimet e ligjit nr. 48/2018, sipas të cilit personelit mësimdhënës që ka përfunduar studimet universitare në ish-institutet e larta pedagogjike, diploma e përfituar i njihet si arsim i lartë, tetë semestra, për efekt page. Në interpretimin literal dhe sistematik të normave, nga përcaktimet e pikës 6 të nenit 72 të ligjit nr. 69/2012, si dhe nga përcaktimet e pikës 2 të nenit 124 të ligjit nr. 80/2015, rezulton se diplomën e nivelit "Bachelor", që i korrespondon nivelit 6 të kornizës shqiptare të kualifikimeve, legjislacioni i arsimit të lartë në asnjë moment nuk e ka përcaktuar si të barasvlershme me një nga diplomat që i përkasin nivelit 7 të kornizës shqiptare të kualifikimeve. Nëpërmjet VKM-së nr. 425/2024 janë materializuar elementet përbërëse të pagës bruto të punonjësve, ndërsa vlera e elementit "shtesa e nivelit të kualifikimit" është e përcaktuar duke zbatuar një logjikë përshkallëzimi sipas diplomës.

24. Lidhur me parimin e sigurisë juridike, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se ai, si një nga elementet e parimit të shtetit të së drejtës, të sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, përfshin, mes të tjerash, besueshmërinë e qytetarëve te shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme. Rregullimet ligjore që kanë të bëjnë me të drejtat e shtetasve duhet të kenë qëndrueshmëri të mjaftueshme që siguron vijimësinë e tyre. Si rregull, nuk mund të mohohen interesa dhe pritshmëri të ligjshme të qytetarëve nga ndryshimet në legjislacion dhe shteti duhet të synojë të ndryshojë një situatë të rregulluar më parë vetëm nëse ndryshimi sjell pasoja pozitive (*shih vendimet nr. 1, datë 25.1.2024; nr. 16, datë 1.3.2017; nr. 43, datë 26.6.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Parimi i sigurisë juridike shoqërohet me mbrojtjen e të drejtave të fituara, vazhdimësinë ligjore, ndalimin e ligjeve me fuqi prapavepruese, qartësinë dhe përcaktueshmërinë në normimin e marrëdhënieve juridike, respektimin e pritshmërive legjitime *(shih vendimet nr. 35, datë 22.11.2022; nr. 16, datë 1.3.2017; nr. 10, datë 29.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Në lidhje me elementin e qartësisë, një rregullim i pasaktë i normës ligjore, që i lë shteg zbatuesit t'i japë asaj kuptime të ndryshme dhe që sjell pasoja, nuk shkon në përputhje me qëllimin, stabilitetin, besueshmërinë dhe efektivitetin që synon vetë norma *(shih vendimet nr. 20, datë 20.4.2021;*

[3] Gjyqtarët Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sandër Beci dhe Sonila Bejtja vlerësuan sipas këtij qëndrimi.

nr. 10, datë 26.2.2015; nr. 36, datë 15.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese).

26. Sipas jurisprudencës kushtetuese, parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e tjera ligjore. Barazia në ligj dhe përpara ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta. Megjithatë, parimi i barazisë nuk e ndalon trajtimin e diferencuar, por trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë mund të përligjet vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive *(shih vendimet nr. 34, datë 10.4.2017; nr. 10, datë 29.2.2016; nr. 71, datë 27.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese).*

27. Në vijim të standardeve kushtetuese, Gjykata, në rastin konkret, duke mbajtur në konsideratë pretendimet dhe prapësimet e palëve në këtë gjykim kushtetues, vëren se objekti i këtij gjykimi kushtetues lidhet me elementin përbërës të pagës bruto mujore, shtesën e nivelit të kualifikimit, e cila, në kuptim të VKM-së nr. 425/2024, shpërblen nivelin arsimor të kërkuar për pozicionin përkatës të punës.

28. Duke vijuar me analizën e kuadrit ligjor dhe nënligjor që rregullon pagën e punonjësve mësimorë, Gjykata vëren se në nenin 8 të ligjit nr. 35/2023 parashikohet se Këshilli i Ministrave miraton elementet përbërëse të pagës bruto dhe vlerën për çdo element të pagës bruto mujore të të punësuarve në institucionet e administratës publike. Në vijim, paga dhe elementet e saj janë rregulluar sipas VKM-së nr. 175/2017, që doli në zbatim të ligjit nr. 69/2012 dhe të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011 "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve". Sipas pikës 3 të VKM-së nr. 175/2017, struktura e pagës mujore për punonjësit mësimorë përbëhet nga katër elemente: a) paga e grupit që është paga e nivelit arsimor; b) shtesa për vjetërsi; c) shtesa për kualifikim; ç) shtesa e pozicionit, e përcaktuar për çdo vend pune sipas emërtesës përkatëse të pozicionit të punës. Vlera e pagës së grupit/e nivelit arsimor për diplomën e ciklit të dytë të studimeve universitare ose të barasvlershme me ato ka qenë 14 000 lekë; për diplomat e ciklit të parë të studimeve universitare "Bachelor" ose të barasvlershme me to vlera ka qenë 11 000 lekë dhe për diplomën e shkollës së mesme pedagogjike me titullin "Mësues i shkollës fillore" vlera ka qenë 10 000 lekë.

29. Me VKM-në nr. 351/2017 u shtua, në fund të pikës 3.a, pra pas pagës së grupit, paragrafi me këtë përmbajtje: "Punonjësit aktualë mësimorë/edukatorë, të cilët zotërojnë diplomë të ciklit të parë të studimeve universitare "Bachelor" ose të barasvlershme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë dhe deri përpara datës 1 mars 2017, kanë përfituar pagën e grupit në masën 14 000 (katërmbëdhjetë mijë) lekë, do të vazhdojnë të përfitojnë të njëjtën masë të pagës së grupit deri në momentin e ndryshimit të nivelit të diplomës, ose ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me institucionin arsimor përkatës. Punonjësit mësimorë/edukatorë që fillojnë punë për herë të parë si punonjës mësimorë/edukatorë në arsimin parauniversitar pas datës 1 mars 2017, do të trajtohen me pagë grupi sipas përcaktimeve të lidhjes nr. 2 të vendimit".

30. Ndërsa me ligjin nr. 48/2018 u shtua në nenin 72 (dispozitat kalimtare) të ligjit nr. 69/2012 parashikimi se personelit mësimdhënës, që ka përfunduar studimet universitare në ish-institutet e larta pedagogjike, diploma e përfituar i njihet si arsim i lartë, tetë semestra, për efekt page. Në referim të nenit 124 të ligjit nr. 80/2015, diplomat e programeve të studimit, të lëshuara në Republikën e Shqipërisë, që kanë zgjatur, së paku, 4 vjet akademikë (8 semestra), deri në përshtatjen e studimeve, sipas parimeve të procesit të Bolonjës, janë ekuivalente me diplomat "Master i shkencave".

31. Ndërsa VKM-ja nr. 425/2024, objekt shqyrtimi, ka ndryshuar elementet përbërëse të pagës bruto për punonjësve mësimorë, duke përcaktuar se ajo përbëhet nga pesë elemente: i. paga për pozicion, që shpërblen vlerën relative të çdo pozicioni pune; ii. shtesa e nivelit të kualifikimit, që shpërblen nivelin arsimor të kërkuar për pozicionin përkatës të punës; iii. shtesa për vjetërsi pune; iv. shtesa për kategoritë e kualifikimit, që shpërblen zhvillimin profesional të punonjësve mësimorë përgjatë karrierës së tyre, pas përfitimit të kategorisë së kualifikimit do të llogaritet në përqindje për çdo kategori, duke filluar nga 10% (mësues i kualifikuar), 20% (mësues special) dhe 30% (mësues mjeshtër); v. shtesa për natyrë të veçantë pune e aplikueshme për disa pozicione në shkollat e arsimit të mesëm të lartë profesional.

32. Në vijim, në analizë të argumenteve për cenimin e parimeve të sigurisë juridike dhe të barazisë përpara ligjit e mosdiskriminimit, në përfundim të diskutimeve, në zbatim të nenit 72, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000.

33. Sipas njërit qëndrim, kërkuesja ka pretenduar cenimin e parimeve të: (i) sigurisë juridike; (ii) barazisë përpara ligjit dhe të mosdiskriminimit. Për parimin e sigurisë juridike, duke marrë në konsideratë argumentet e parashtruara nga kërkuesja dhe analizën e VKM-së nr. 425/2024, u vlerësua se për të arritur në përfundimin nëse në rastin konkret është cenuar ky parim duhet të analizohet nëse elementi "shtesa e nivelit të kualifikimit", një nga pesë elementet që përbëjnë pagën në tërësi sipas përcaktimit të VKM-së nr. 425/2024, përbën të drejtë të fituar, që gëzon mbrojtje nga parimi kushtetues i sigurisë juridike. Nga parashtrimet e palëve dhe shpjegimet e tyre u vërtetua se paga në tërësi për punonjësit e arsimit parauniversitar ka pësuar rritje në krahasim me pagën e mëparshme, fakt i konfirmuar edhe nga kërkuesja gjatë seancës plenare. Kërkuesja nuk arriti të parashtronte argumente nëse ndryshimi në llogaritjen e elementit të shtesës së nivelit të kualifikimit kishte sjellë pasoja negative në llogaritjen e pagës në tërësi, pasi në fakt, e drejta ligjore e fituar është paga në tërësinë e saj e përbërë nga pesë elementet sipas VKM-së nr. 425/2024 dhe jo elementet e veçanta të saj. Gjithashtu, gjatë shqyrtimit të çështjes, nga kërkuesja nuk u parashtrua asnjë argument për të provuar sesi ndryshimi i këtij elementi do të sillte pasoja në të ardhmen në të drejta, si e drejta për pension, për të cilën, në fakt, merret për bazë vlera e pagës në tërësi dhe jo elementet e veçanta të saj. Për këtë gjitha këto arsye, u vlerësua se e drejta ligjore e fituar, paga, nuk është cenuar dhe pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike nuk është i bazuar. Në lidhje me pretendimet për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit dhe të mosdiskriminimit, evidentohet se njohja e diplomave për efekt page, për sa i përket personelit mësimdhënës, lidhet me zbatimin e nenit 72, pika 6, të ligjit nr. 48/2018, në të cilin parashikohet se personelit mësimdhënës, që ka përfunduar studimet universitare në ish-institutet e larta pedagogjike, diploma e përfituar i njihet si arsim i lartë, tetë semestra, për efekt page. Ky parashikim ka dy elemente: (i) formal, që lidhet me emërtimin e institucionit të studimeve universitare (institute të larta pedagogjike/universitet); (ii) substancial, për njohjen e diplomave për efekte të përfitimit të pagës. Në lidhje me elementin substancial, për të cilin janë edhe pretendimet në rastin konkret, pavarësisht çdo emërtimi formal të institucionit, punonjësi i arsimit parauniversitar që ka përfunduar arsimin me tetë semetra, që në referim të nenit 124 të ligjit nr. 80/2015 është ekuivalent me diplomën "Master i shkencave", për çdo pretendim për interpretimin dhe zbatimin e parashikimit ligjor mund t'i drejtohet gjykatës së juridiksionit të zakonshëm. Ndërsa për të gjitha kategoritë e punonjësve, që përfitojnë llogaritjen e pagës sipas arsimit përkatës, pas përshtatjes së sistemit të Bolonjës, parashikimi i VKM-së nr. 425/2024 nuk ka cenuar parimin e barazisë përpara ligjit dhe të mosdiskriminimit[4].

34. Sipas qëndrimit tjetër, duke u nisur nga analiza e ligjit nr. 48/2018 vlerësohet se përbën të drejtë të fituar njohja dhe njësimi i diplomës për efekt page me atë të arsimit të lartë, të barasvlershme me tetë semestra, për: (i) personelin mësimdhënës që ka filluar dhe përfunduar studimet në ish-institutet pedagogjike deri në vitin 2007, gjë që u konfirmua edhe nga shpjegimet e subjektit të interesuar në seancën gjyqësore të gjykimit kushtetues; (ii) personelin mësimdhënës që ka filluar studimet në ish-institutet pedagogjike dhe i ka përfunduar në fakultetet përkatëse të mësuesisë; (iii) personelin mësimdhënës që ka filluar dhe mbaruar studimet në fakultetet e mësuesisë deri në momentin e hyrjes në fuqi të zbatimit të detyrimeve të Kartës së Bolonjës. Për rrjedhojë, Këshilli i Ministrave me nxjerrjen e VKM-së nr. 425/2024, me të cilën nuk e njeh në të njëjtën mënyrë ekuivalentimin e diplomës si një të drejtë të fituar për kategoritë e mësipërme të listuara në pikat (ii) dhe (iii), ka

[4] Gjyqtarët Holta Zaçaj, Sonila Bejtja, Ilir Toska dhe Genti Ibrahimi votuan sipas këtij qëndrimi

cenuar pritshmëritë e ligjshme të atyre kategorive, si dhe i ka diferencuar ato pa një arsye të përligjur dhe objektive, duke cenuar në këtë mënyrë parimet e sigurisë juridike dhe të barazisë përpara ligjit e të mosdiskriminimit. Rregullat e VKM-së nr. 425/2024 nuk mund të tejkalohen nëpërmjet interpretimit të ligjit nga gjykatat e zakonshme, ndaj riparimi i këtyre të drejtave të cenuara mund të arrihet vetëm nëpërmjet shfuqizimit të VKM-së për këtë pjesë. Kjo do të thotë se pretendimet e kërkueses për këto kategori të personelit mësimdhënës janë të bazuara. Ndërsa për personelin mësimdhënës që ka filluar punë pas hyrjes në fuqi të detyrimeve të Kartës së Bolonjës, marrin vlerë kriteret e lidhura me nivelin e kualifikimit sipas skemës së parashikuar nga VKM-ja nr. 425/2024, ku evidentohet domosdoshmëria e marrjes së një diplome në programin "Master" për t'u përfituar paga bazë në vlerën 14 000 lekë, për rrjedhojë pretendimi për cenimin e parimeve të sigurisë juridike dhe të barazisë përpara ligjit e të mosdiskriminimit për atë kategori nuk është i bazuar[5].

35. Për shkak të qëndrimeve të mësipërme, Gjykata konstatoi se nuk ishte e mundur të formohej numri i kërkuar prej 5 gjyqtarësh për të vijuar më tej shqyrtimin dhe vendimmarrjen për themelin e pretendimeve që lidheshin me cenimin e parimeve të sigurisë juridike dhe të barazisë përpara ligjit e të mosdiskriminimit.

36. Për sa më lart, Gjykata vëren se në kushtet kur nuk u formua shumica prej 5 gjyqtarësh, në kuptim të nenit 73, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000, kërkesa e kërkueses konsiderohet e rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "c" dhe 134, pika 1, shkronja "h", të Kushtetutës, si dhe neneve 72, 73, pika 4 dhe vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 24.7.2025.
Shpallur më 28.10.2025.

Kryetare: Holta Zaçaj
Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Genti Ibrahimi, Ilir Toska, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Marjana Semini

VENDIM
Nr. 271, datë 31.10.2025

MBI SHQYRTIMIN E KËRKESAVE TË SHOQATËS "TAKSITË E KLASIT TË PARË" DHE SINDIKATËS SHQIPTARE TË TAKSIVE PËR PEZULLIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 255, DATË 15.10.2025 "MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR KARIKIMIN E MAKINAVE ELEKTRIKE NË PIKAT/STACIONET E KARIKIMIT, ME FUQI TË INSTALUAR MBI 11 kW"

Në mbështetje të neneve 16, 19, germa "ë" dhe 81, pika 2, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; neneve 33, 65, germa "ç", nenit 133, dhe nenit 180, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; si dhe neneve 15 dhe 16, pika 5 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.10.2025, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2739 prot., datë 28.10.2025, të përgatitur nga drejtoritë teknike, "Mbi shqyrtimin e kërkesave të Shoqatës 'Taksitë e Klasit të Parë' dhe të Sindikatës Shqiptare të Taksive për pezullimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 255, datë 15.10.2025",

Konstatoi se:

- Enti Rregullator i Energjisë (ERE), me vendimin nr. 255, datë 15.10.2025, ka vendosur ndër të tjera; *miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike prej 22 lekë/kWh për karikimin e makinave elektrike në pikat/stacionet me fuqi të instaluar mbi 11 kW dhe*

[5] Gjyqtarët Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sandër Beci dhe Marjana Semini votuan sipas këtij qëndrimi.

aplikimin e çmimit të diferencuar në orarin e pikut, me hyrje në fuqi nga data 1 nëntor 2025.

- Më datë 23.10.2025, i janë drejtuar ERE-s dhe Ministrisë se Infrastrukturës dhe Energjisë dy kërkesa të veçuara nga Shoqata "Taksitë e Klasit të Parë" dhe "Sindikata Shqiptare e Taksive", të cilat kundërshtojnë vendimin e Bordit nr. 255, datë 15.10.2025, duke kërkuar: *(1) pezullimin e menjëhershëm të zbatimit të tarifës së re deri në zhvillimin e një dëgjimi publik me Shoqatën dhe grupet e tjera të interesit; (2) rishikimin e tarifës, me qëllim vendosjen e një çmimi preferencial për karikimin e taksive elektrike, si sektor publik me ndikim social dhe mjedisor; (3) krijimin e një mekanizmi subvencioni ose lehtësie fiskale, për të shmangur kthimin e investimit ekologjik të qindra shoferëve në barrë ekonomike*" dhe; *"Sindikata Shqiptare e Taksive"* ka kërkuar:

I. Legjitimiteti i palëve dhe afatet procedurale

- Për sa i përket legjitimitetit të palëve, në kuptim të nenit 3, pika 7, germa "b" dhe nenit 33, pikat 2 dhe 3 të Kodit të Procedurave Administrative, Shoqata "Taksitë e Klasit të Parë" dhe "Sindikata Shqiptare e Taksive" përfaqësojnë një kategori të përcaktueshme përdoruesish (taksitë elektrike të regjistruara për ushtrim aktiviteti), të cilët mund të preken drejtpërdrejt nga vendimi nr. 255/2025, vlerësohet njohja e tyre si palë në procedurë. Po ashtu, nga verifikimi paraprak i dokumentacionit rezulton se kërkesat janë paraqitur brenda afatit 7-ditor (shtatëditor) ligjor, në përputhje me nenin 16, pika 5 të ligjit nr. 43/2015.

II. Objekti i kërkesave

- Rezulton se kërkesat e sipërcituara lidhen me të njëjtin akt administrativ dhe kanë objekt të njëjtë, si dhe mbështeten në të njëjtat rrethana faktike dhe ligjore, vlerësohet bashkimi i tyre në një procedurë të vetme administrative. Në përputhje me parashikimet e nenit 65, germa "ç", të Kodit të Procedurave Administrative (KPA), kërkesat do të trajtohen bashkërisht me qëllim trajtim më efikas të çështjes dhe duke garantuar respektimin e parimeve të sigurisë juridike, proporcionalitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

III. Rrethanat e vendimmarrjes nr. 255/2015

- Vendimi nr. 255, datë 15.10.2025, i Bordit të ERE-s ka për qëllim reflektimin e kostove të disbalancave dhe garantimin e funksionimit të qëndrueshëm të sistemit elektroenergjetik dhe të furnizimit universal, si elemente që përbëjnë interes publik të mbrojtur nga ligji.

- Vendimi është marrë në vijim të kërkesës së FSHU sh.a., me shkresën nr. 5199 prot., datë 3.10.2025, për përcaktimin e një çmimi të diferencuar për karikimin e makinave elektrike në pikat/stacionet me fuqi të instaluar mbi 11 kW, për shkak të rritjes së ndjeshme të konsumit dhe të kostove të disbalancave gjatë vitit 2025.

- Në mbështetje të nenit 81, pika 2, të ligjit nr. 43/2015, ku përcaktohet se klientët fundorë janë përgjegjës përballë furnizuesit për disbalancat e shkaktuara, ERE vlerësoi se kostoja e shtuar e disbalancave duhet të reflektohet te çmimi i energjisë për këtë nën-kategori konsumatorësh, me qëllim shmangien e transferimit të barrës financiare te konsumatorët e tjerë të shërbimit universal.

- Në vlerësimin e ERE-s u çmua se kërkesa e FSHU sh.a., paraqiste nevojën për kategorizimin e një grupi të ri konsumatorësh – pikave dhe stacioneve të karikimit me fuqi të instaluar mbi 11 kW të lidhura në nivelin e tensionit 0.4 kV. Për këtë kategori, u përcaktua çmimi 22 lekë/kWh, që do të zbatohet nga data 1 nëntor 2025, ndërsa për konsumatorët me fuqi të instaluar deri në 11 kW do të vijojnë të aplikohen çmimet ekzistuese. Për konsumin në orët e pikut aplikohet çmim 15% më i lartë se energjia e aktive e konsumuar sikurse aplikohet dhe në kategoritë e tjera konsumtarore. Për konsumatorët me fuqi deri në 11 kW, vijojnë çmimet ekzistuese të shërbimit universal.

- Për sa më sipër u vlerësua se vendimmarrja adresoi në mënyrë të drejtë ndikimin në rrjet nga rritja e karikimit me fuqi të lartë, duke ruajtur interesin publik, stabilitetin teknik dhe financiar të sistemit elektroenergjitik, si dhe parimet ligjore mbi të cilat përcaktohen tarifat e rrjeteve dhe çmimet e shitjes së energjisë elektrike të aplikueshme ndaj përdoruesve të rrjetit dhe konsumatorët fundorë.

IV. Për sa i përket kërkesës në lidhje ***me pezullimin e menjëhershëm*** të zbatimit të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 255, datë 15.10.2025, vlerësohet se:

- Në zbatim të nenit 133, pika 3, germa "c", të Kodit të Procedurave Administrative, pezullimi i një akti administrativ nuk lejohet kur zbatimi i tij është në interes publik. Vendimi nr. 255/2025 ka për qëllim garantimin e funksionimit të qëndrueshëm financiar dhe stabiliteti teknik të furnizimit universal (FSHU) dhe mbulimin e kostove të disbalancave të shkaktuara tashmë në sistem nga përdoruesit e

stacioneve të karikimit me fuqi të instaluar mbi 11 kW, në mbrojtje të interesit publik.

- Sipas nenit 180 të Kodit të Procedurave Administrative, pezullimi i ekzekutimit mund të vendoset vetëm kur provohet rreziku i një dëmi të rëndë dhe të pazëvendësueshëm për subjektin, pa cenuar interesin publik rrethana që në këtë rast nuk janë provuar nga palët kërkuese.

- Zbatimi i vendimit nuk u shkakton një dëm të pariparueshëm palëve kërkuese, ndërsa pezullimi i tij do të krijonte pasoja të drejtpërdrejta financiare për konsumatorët e tjerë të shërbimit universal dhe do të cenonte sigurinë e furnizimit.

- Subjektet ruajnë të drejtën e zgjedhjes së mënyrës së furnizimit, duke mundur të furnizohen me çmimet ekzistuese për fuqinë nën 11 kW ose të përdorin stacionet mbi këtë prag, kundrejt çmimit të miratuar nga Bordi i ERE-s. Aktualisht konsumatorë të cilët përdorin makina elektrike, kanë mundësinë të furnizohen nga FSHU me çmimet përkatëse të pandryshuara prej 8.5 lekë/kWh ose 9.5lekë/kWh në varësi të konsumit dhe për konsumatorë jo familjarë me çmimin prej 14 lekë / kWh.

- Për rrjedhojë, kërkesa për pezullim të menjëhershëm të zbatimit të vendimit nr. 255/2025 nuk është e bazuar në prova dhe në kuadrin ligjor në fuqi.

V. Lidhur me kërkesën e palëve ***për krijimin e një mekanizmi subvencioni ose lehtësish fiskale*** për kategorinë e taksive elektrike, vlerësohet se:

- ERE, në ushtrimin e kompetencave të saj, ka detyrimin të garantojë shmangien e ndërsubvencionimit ndërmjet kategorive të konsumatorëve, duke siguruar që çmimet dhe tarifat të mbështeten në koston reale që secila kategori i shkakton sistemit, në përputhje me nenin 19, germa "ë" të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

- ERE nuk mund të vendosë skema financiare që do të transferonin barrën e kostove nga një kategori konsumatorësh te një tjetër, pasi kjo do të binte ndesh me parimet e transparencës, proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit tarifor të përcaktuara në kuadrin ligjor të sektorit të energjisë.

- Subvencionet, incentivat ekonomike dhe lehtësitë fiskale për kategori të veçanta përdoruesish janë instrumente të politikave publike që vendosen nga organet kompetente të politikës fiskale dhe të transportit, si Ministria e Financave dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

- Për rrjedhojë, kjo çështje nuk përbën objekt vendimmarrjeje të Bordit të ERE-s, ndërkohë që shqetësimet e ngritura nga përdoruesit e taksive elektrike, edhe pse përbëjnë interesa legjitimë publikë, janë adresuar për kompetencë pranë institucioneve përkatëse dhe nuk mund të trajtohen përmes rishikimit të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 255, datë 15.10.2025.

VI. Lidhur me kërkesën e palëve ***për rishikimin*** e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 255, datë 15.10.2025, vlerësohet se:

- ERE do të shprehet në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative, legjislacionit sektorial në fuqi dhe afateve ligjore të përcaktuara për këtë procedurë.

- Në këtë kuadër, ERE do të vijojë shqyrtimin administrativ të kërkesës për rishikim, duke vlerësuar nëse parashtrimet e palëve përmbushin kushtet dhe kriteret e përcaktuara në kuadrin ligjor për rishikimin e akteve administrative.

- Pas vlerësimit të plotë të rrethanave dhe provave në themel të çështjes, Bordi i ERE-s do të shprehet me vendim përfundimtar brenda afateve ligjore të parashikuara për këtë procedurë.

Në përfundim dhe për sa më sipër argumentuar vlerësojmë se vendimi i Bordit nr. 255/2025 ka si qëllim reflektimin e kostove të disbalancave dhe garantimin e funksionimit të qëndrueshëm financiar dhe stabilitet të rrjetit, elemente që përbëjnë interes publik të mbrojtur nga ligji. Për rrjedhojë, kërkesa për pezullim të menjëhershëm të zbatimit të vendimit nuk qëndron në kuptim të nenit 133 e në vijim të Kodit të Procedurave Administrative.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të refuzojë kërkesat e Shoqatës "Taksitë e Klasit të Parë" dhe Sindikatës Shqiptare të Taksive për pezullimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 255, datë 15.10.2025, "Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për karikimin e makinave elektrike në pikat/stacionet e karikimit me fuqi të instaluar mbi 11 kW".

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë të palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

KËRKESË
Nr. 356/15, datë 28.10.2025

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën, "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 1056, datë 14.12.2013, të Këshillit të Ministrave, 'Për shpronësim për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor 'By Pass – Fier'"', të ndryshuar.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, sipas tabelës bashkëlidhur kësaj kërkese.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar, dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim.

Vlera totale paraprake e shpronësimit 2,342,218 (dy milionë e treqind e dyzet e dy mijë e dyqind e tetëmbëdhjetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena

LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARËVE, PASURITË PRONË PRIVATE, E TË CILËVE SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT "PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VKM-në NR. 1056, DATË 14.12.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, 'PËR SHPRONËSIM PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR 'BY PASS – FIER'", TË NDRYSHUAR

	PRONARI			TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)				VLERËSIMI PËR SHPRONËSIM				
				TË DHËNAT E PASURISË				TOKË ARË				
Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Numri pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale (m²)	Sipërfaqja e shpronësuar (m2)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	VLERA Totale (LEKË)	SHËNIMET
Zvogëlim sipërfaqeje në VKM-në nr. 724, datë 16.9.2020												
26	Bedrije Shaqe Bektash Nexhmije Valentina Shkelqim	Pasho Latif Pasho Pasho Pasho Pasho	Mehmetaj Agalliu Veliu Guri Jermini Veliu	2636	128/25	ullishte	900	730	437	319,010	319,010	Konfirmuar nga Ashk
Pasuritë që shtohen në VKM-në 1056, datë 14.12.2013												
1	Selim	Musa	Veliu	2636	73/14	arë	11564	846	437	369,702	369,702	Me VKM-në nr. 980, datë 1.12.20 pezullohet veprimi deri në regjistrimin e rrugës
2	Nesti	Zogu	Profka	3436	58/80	arë	1320	1137	299	339,963	339,963	Konfirmuar nga ASHK-ja
3	Nasi	Todi	Zhezha	3980	4/1	arë	2220	1532	684	1,047,888	1,047,888	Konfirmuar nga ASHK-ja
4	Refat	Jonuz	Braka	2436	121/36	arë	7980	793	335	265,655	265,655	Konfirmuar nga ASHK-ja
	Shuma paraprake										**2,342,218**	
	Efekti financiar shtesë										**2,023,208**	

KËRKESË
Nr. 425/10, datë 29.10.2025

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 684, datë 23.10.2019, 'Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Ndërtimi i nënstacionit 400 kV Fier'"', të ndryshuar.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur për pasuritë e llojit "arë" dhe "kultura bujqësore", bazuar në pikën 4, të nenit 17 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik", të ndryshuar; marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligjin nr. 101/2017, "Për ratifikimin e marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW Frankfurt am Main, në lidhje me marrëveshjen e huas ndërmjet Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a. (OST) dhe KfW Frankfurt am Main, për projektin "Linja e transmetimit 400 kV Shqipëri–Maqedoni (Fier–Elbasan–Qafëthanë)" dhe marrëveshja e Huas lidhur ndërmjet OST sh.a. dhe KfW, më datë 18.1.2016, Marrëveshja e Veçantë e Projektit, lidhur ndërmjet OST sh.a. dhe KfW, më datë 18.1.2016, në bazë të të cilave është hartuar raporti i vlerësimit, i miratuar bazuar në Planin e Marrjes së Tokës dhe Kompensimit LACP (RAP), sipas tabelës bashkëlidhur.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar, dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a., si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 36,569,266 (tridhjetë e gjashtë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë (nga të cilat 23,441,493 lekë i shtohen vlerës së miratuar me VKM-në nr. 684/2019).

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE TË PASURIVE, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "NDËRTIMI I NËNSTACIONIT 400 kV FIER"

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	Lloji i pasurisë	ZK	Nr. pasurie	Sip. e pronës (m²)	Sip. që shpronësohet (m²)	Çmimi i tokës (lekë/m²)	Vlera e kulturave bujqësore (lekë)	Vlera e shpronësimit të tokës (lekë)	Vlera totale e shpronësi-mit (lekë)	Shënime
	Bashkia Fier/fshati Drizë	**Zona kadastrale nr. 1557**									
1	Shaban Sihat Gjeli	Arë	1557	190/1	2,218	2,218	676	1,383	1,499,368.0	**1,500,751**	
2	Iljaz Nurçe Shateri	Arë	1557	192/1	878	878	676	547	593,528	**594,075**	Pa certifikatë pronësie
3	Nuredin Iljas Shatëri	Arë	1557	192/2	437	437	676	273	295,412	**295,685**	
4	Fatmir Xhemil Brakaj Tajane Jakup Brakaj	Arë	1557	250/7	4,557	4,557	676	55,140	3,080,532	**3,135,672**	
5	Ymer Dine Muhametaj Florije Ymer Malaj Vjollca Ymer Kodhelaj	Arë	1557	250/95	3,777	3,777	676	897,635	2,553,252	**3,450,887**	
6	Shtet	Arë	1557	250/96	410	410	-	-	-	**-**	
7	Lavdosh Ismail Muhametaj Afërdita Yemin Muhametaj Riziana Lavdosh Muhametaj Ismail Lavdosh Muhametaj Muhamet Ismail Muhametaj Drita Ismail Bogdani Feruze Ismail Gjishti Xixëllonja Ismail Xheka	Arë	1557	250/82	2,827	2,827	676	14,619	1,911,052	**1,925,671**	
8	Shtet	Arë	1557	250/83	218	218	-	-	-	**-**	
9	Fetah Rapush Hoxha	Arë	1557	250/10	2,312	2,312	676	1,491,707	1,562,912	**3,054,619**	
10	Ali Kodhel Myrtaj	Arë	1557	250/12	406	406	676	352,585	274,456	**627,041**	
11	Zini Ali Myrtaj	Arë	1557	250/13	2,093	2,093	676	3,064,780	1,414,868	**4,479,648**	
12	Shpresa Rrapo Myrtaj	Arë	1557	250/14	1,937	1,937	676	2,413,854	1,309,412	**3,723,266**	
13	Xhevair Ali Myrtaj	Arë	1557	250/15	1,625	1,625	676	2,413,854	1,098,500	**3,512,354**	
14	Luan Hydai Gjata	Arë	1557	250/16	562	562	676	339,549	379,912	**719,461**	
15	Agron Idai Gjata	Arë	1557	250/17	875	875	676	339,549	591,500	**931,049**	
16	Kostandin Vangjel Saramanda	Arë	1557	250/18	1,078	1,078	676	-	728,728	**728,728**	
17	Zoi Vangjel Saramanda	Arë	1557	250/19	1,078	1,078	676	-	728,728	**728,728**	
18	Bani Llazi Bare	Arë	1557	250/20	1,000	1,000	676	624	676,000	**676,624**	
19	Filip Tezho Baraj	Arë	1557	250/22	1,000	1,000	676	624	676,000	**676,624**	

20	Mihal Tezho Baraj Lefteri Naun Baraj Roland Mihal Baraj Majlinda Idajet Baraj Nikola Roland Baraj Emiliano Roland Baraj Mateo Roland Baraj	Arë	1557	250/92	1,022	1,022	676	624	690,872	**691,496**	Me AMTP i referohet pasurisë nr. 250/23
21	Nikollaq Todi Bare	Arë	1557	250/25	1,776	1,776	676	1,107	1,200,576	**1,201,683**	
22	Fetih Meto Gjata	Arë	1557	250/26	974	974	676	-	658,424	**658,424**	
23	Flutura Feti Avdulaj	Arë	1557	250/27	187	187	676	117	126,412	**126,529**	
24	Ismet Fetih Gjata	Arë	1557	250/28	1,278	1,278	676	797	863,928	**864,725**	
25	Ariste Naun Bare Vladimir Mihal Bare Aurel Mihal Bare Katerina Jani Stavro Aleksandra Aurel Bare	Arë	1557	250/29	1,407	1,407	676	877	951,132	**952,009**	
26	Artur Sotir Bare	Arë	1557	250/30	898	898	676	10,866	607,048	**617,914**	
27	Spiro Ndreu Bare	Arë	1557	250/80	1,029	1,029	676	-	695,604	**695,604**	
	Vlera totale e shpronësimit (lekë)							**11,401,110**	**25,168,156**	**36,569,266**	

KËRKESË

Shtetasja Rudina Zaloshnja kërkon pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, shpalljen të zhdukur të shtetasit Xhavit Muça, me atësi Beqir dhe amësi Hajrije, i datëlindjes 16.5.1941, lindur dhe banues në Tiranë.

KËRKUESE
Rudina Zaloshnja

KORRIGJIM GABIMI MATERIAL

Në vendimin nr. 418, datë 23.7.2025, të Këshillit të Ministrave, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, 'Për miratimin e rregullores së zhvillimit të Territorit', të ndryshuar", botuar në Fletoren Zyrtare nr. 133, datë 25.7.2024, bëhet korrigjimi si më poshtë:

Në përmbajtjen e nenit 13, shkronja "b", togfjalëshi **"pas pikës 9 shtohet pika 10"** ndryshohet me togfjalëshin **"pas pikës 8 shtohet pika 9".**

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 272 lekë

Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Date:2025/10/31 13:30:33 +02'00'
dcab4392f6c94a64910985583c7930ad2025103113302561031

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)